

Parlamenti
Ligji për gjuhët
pret fundin
e janarit

Fq.3



Financimi
i universiteteve
Për kampusin e
UNT-së, as gjysma
e premtuar

Fq.7



Kosova ka
Majlindën,
Maqedonia
Hamza
Jasharin

Fq.12



Koha

www.koha.mk



Shpendi edhe
një mandat

Fq.16

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3231 · E hënë 27 nëntor 2017

1°C | +6°C

15 DEN

AKTUALE

Ndryshojnë
prioritetet
në kulturë



Filmi apo botimet e muzika nuk gjenden në top listën e veprimtarive të financuara më shumë, ashtu si vitet e tjera. Pa ndonjë reduktim të ndjeshëm të buxhetit janë Drama, Folklori, ndërsa zëra të tjerë si Trashëgimia, Manifestimet kulturore artistike, Muze të, Talentet e reja, Eurointegrimet janë prioritet e reja ku do të shkojë pjesa më e madhe e buxhetit

Fq.8

SPECIALE

"Të çmendurit
e nderit" dhe
mafiozët e
vërtetë

Fq.18

GLOBI

Sophia, roboti
i parë në botë
me shtetësi
dëshiron të
krijojë familje

Fq.17



PROKURORIA E KUMANOVËS TENTON TA SHPËTOJË BOBAN ILIQIN VRASJE E DYFISHTË E 4-VJEÇARIT



"Në këtë fazë të procesit gjyqësor, kur jemi para dhënies së fjalëve përfundimtare, për ne është e papranueshme që kjo vepër penale të ndryshohet. Të gjitha dëshmitë verbale dhe materiale të prezantuara deri më tani tregojnë qartë se bëhet fjalë 'vrasje me paramendim'. Mirëpo, prokuroria vazhdon të bëhet e shurdhër ndaj provave tona", ankohet avokati Alispahiç

Fq.5

Gazifikimi dhe transporti publik, zgjidhje për ndotjen

Tetovë, 26 nëntor - Me afrimin e stinës së dimrit, po intensifikohet rritja e pranisë së grimcave të dëmshme PM10 në ajër. Përveç erës së pakëndshme të tymit, edhe të dhënat zyrtare nga stacioni matës i Ministrisë së Ambientit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor tregojnë për ajrin e ndotur, që gjithnjë e më shumë ditëve të fundit është prezent në qytetin e Tetovës. Fillimin e muajt e karakterizonte rritja e materieve të dëmshme në ajër,

pak më shumë se kufiri i lejuar që është 50 mikrogram në një metër kub. Ashti siç po kalojnë ditët e muajt, po ashtu rritet koncentrimi i materieve helmuese në ajër. Në dy ditët e kaluara, më saktësisht të enjten, më 23 nëntor, kishte 187 grimca PM 10. Në dy ditët e mëparshme nuk kishte të dhëna në Uebfaqen zyrtare të Ministrisë së Ambientit rreth asaj se sa kanë arritur materiet e dëmshme në ajër...

Fq.9



EDITORIAL

MOS PREKNI
TE ALMIRI

Vedat MEMEDALIU

Bojan Iliq, i riu nga Kumanova që më 25 qershor të vitit të kaluar, me veturë përplasi për vdekje 4-vjeçarin, Almir Aliu, bashkë me prindërit afër Spitalit të Kumanovës - mund të kalojë me dënim minimal. Kështu po tenton të vendos Trupi gjykues dhe Prokuroria e Kumanovës, të cilët përveç zvarritjes pa fund të procesit gjyqësor, ditëve të fundit kanë nis të nxjerrin dhe "brirët" dhe "vrasin" për së dyti vogëlushin e pafajshëm, trupi i njomë i të cilit po kalbet në varrezat e qytetit të Kumanovës.

Propozimi për rikualifikim të lëndës nga "vrasje me paramendim" në "aksident rrugor me pasojë vdekjen" ka revoltuar secilin shqiptarë, të cilët tashmë po thellojnë mosbesimin ndaj gjyqësorit dhe drejtësisë maqedonase. Për të mos mjaftuar kjo, edhe babai i Almiri, Sedati - vazhdon të gjykohe për dhunë dhe shkaktim të lëndimeve ndaj vrasësit Iliq, edhe pse vëllai i këtij të fundit, nuk përmendet tani në seancat gjyqësore si bashkëpunëtor në vrasje. Janë dy prokurorët e Kumanovës, Suzana Kusigerska dhe Goran Peshevski ata që po kërkojnë me ngulm që Bojan Iliqi (me dosje voluminoze në policinë e qytetit) të dënohet për vepër penale "aksident rrugor me pasojë vdekjen". Vendim përfundimtar akoma nuk ka dhe me gjasë, gjykim në afatin e paraparë - më 29 nëntor, nuk do ketë. Por, para se Iliqi të dënohet maksimalisht me vetëm 4 vjet burg, familjarët e Almiri duhet ndihmuar. Ndihmë duhet të jap edhe ministri shqiptar i Drejtësisë, edhe ushtruesi i detyrës Prokurori i Përgjithshëm, Xhelal Bajrami. Ndihmë dhe presion duhet të bëjnë dhe partitë politike shqiptare, mediat, organizatat joqeveritare, qytetarët...

Mjafton të përkujtojmë vetëm rastin e 20-vjeçarit nga fshati Gërçec i Sarajit, Naser Eshtrefi, i cili nga gjykata famëkeqe e Shkupit, dy vjet më parë mori dënimin maksimal - 14 vjet burg. Naseri ishte akuzuar se "me paramendim", tre vjet më parë, kishte vrasur maturanin Angel Petrovski. Edhe pse asnjëherë Prokuroria dhe Gjykata nuk arriti të sigurojë motivin e vrasjes, për të cilën Naseri dhe pala mbrojtëse thoshte se ka qenë "vetëmbrojtje" nga goditjet e babait të Angelit, Trupi gjykues e çoi në qeli për 14 vjet të riun e Gërçecit. Arma, që herë thuhej se ishte një thikë e herë mjet i mprehtë prej metali, nuk u gjet asnjëherë. Nuk u gjet, sepse ajo ishte e babait të Angelit dhe nuk u kërkuar si dëshmi në asnjë nga seancat gjyqësore. Për të mos mjaftuar kjo, huliganët maqedonas të "Gjorçe Petrovit" dogjën dhe shkatërruan gjithçka që ishte shqiptare në këtë lagje të Shkupit - flaka iu vu dyqaneve, u rrahën, madje, edhe gratë... Dhe deri sot, asnjë dënim dhe asnjë akuzë ndaj tyre.



MADAGASKARI NJEH PAVARËSINË E KOSOVËS
Njohja më e re për vendin vjen nga Madagaskari. Lajmin e ka bërë publik zëvendëskryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës Behgjet Pacolli. "Urime Kosove, faleminderit Madagaskar. Nga sot Kosova dhe Madagaskari kanë nga një mik më shumë. Falënderimet e mijta të sinqerta për popullin, Presidentin dhe Qeverinë e Madagaskarit", shkruan Pacolli në Facebook.

PRESIM KAPJEN E PESHQVE TË MËDHENJ

"Nuk do të komentoj çështjen Tahiri, pasi ne politikanët nuk duhet të komentojmë për çështje që janë sërish në proces. Le të lemë drejtësinë të flasë për këtë. Përgjithësisht, dua të them që Shqipëria ka shanse të mira për vitin e ardhshëm për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Në shkurt Komisioni do të publikojë strategjinë e zgjerimit, në prill progres raportet. Pra, keni më shumë kohë për rezultate. Nga ç'po dëgjojmë nga Komisioni Evropian, Vetingu ka filluar. Zonja Ruiz Calavera tha, se Vetingu po shkon mirë. Nuk ka shumë burime financiare, por problemet mund të zgjidhen, pasi ato janë identifikuar dhe mund të korrigjohen. Pra, mos e dëmtoni këtë moment. Mos e prishni procesin. Presim kapjen e peshqve të mëdhenj siç ka deklaruar ambasadori amerikan në Tiranë apo edhe komisioneri Hahn më parë!", shkruan eurodeputeti Eduard Kukan në Twitter.

DIFERENCA PA PËRSËRITJE

"Kuptimi i rinumërimit ishte sabotimi i numërimit. Ankesat e LDK dhe PDK, në Prishtinë dhe në Prizren, ishin ankesa humbësish që nuk duan ta pranojnë humbjen. Donin rinumërim që të mos mbaronte numërimi i cili do të vuloste fituesit e ditur. Rinumërimi do ta ndërprente numërimin, fillimi i rinumërimit do ta përjetësonte pambarimin e numërimit, drejt rivotimit të synuar për shkak të rezultatit të padëshiruar. Vendimi i PZAP ishte bazuar në ato ankesa të pakta, të varfra, e të dobëta, përmbajtësisht, logjikisht e gjuhësisht. Gjykata Supreme nuk do të mund ta pranonte këtë vendim të PZAP pa diskredituar veten e saj. Gjykata Supreme nuk mbrojti Lëvizjen VETËVENDOSJE! Madje, ajo nuk mbrojti as vetëm të drejtën dhe të vërtetën. Gjykata Supreme mbrojti vetveten. Ajo ndodhej në një situatë groteske: çfarëdo qëndrimi tjetër do ta zhvlerësonte vetë Gjykatën Supreme. Nuk ishin në pyetje vetëm e drejta dhe e vërteta por edhe vetë instanca supreme juridike për këto. Gjykata Supreme vendosi në favor të Gjykatës Supreme. Le të numërohen qetë e me vigjilencë votat e mbetura. Nuk do të përsëritet numërimi. Le të përsëritet festimi", shkruan në FB, Albin Kurti.

VUÇIQI I KOSOVËS

"Vuçiqi me 9 deputetë në Kuvend të Kosovës, 10 kryetarë komunash dhe fuqinë brenda Qeverisë Haradinaj, do të synojë të kapitalizojë drejt plansynimit të ardhshëm - ndarjes së Kosovës. Kjo temë tash është hapur në qarqe të ndryshme politike e diplomatike në SHBA e Evropë. E liderët e Kosovës po vazhdojnë të merren me vetveten...", shkruan kryeredaktori i KTV-së, Adriatik Kelmendi në FB.



MEDIACitate

Autoritetet egjiptian që po hetojnë masakrën në një xhami të Sinait, thanë se agresorët mbanin flamurin e Shtetit Islamik. Te paktën 305 vetë humbën jetën në sulmin me bombë e armë zjarri gjatë lutjeve të së premtës, i konsideruar si me vdekjeprurësi në historinë moderne të Egjiptit. Deri më tani asnjë grup nuk e ka marrë përsipër autorësinë e tij. Prokurori publik i Egjiptit tha se në vendin e ngjarjes ishin parë rreth 30 agresorë. Presidenti egjiptian, Abdul Fatah Al Sisi u zotua t'i përgjigjej me forcën më ekstreme tragjedisë dhe të shtunën ushtria njoftoi se kishte zhvilluar sulmet e para ajrore ndaj shënjestrave terroriste, siç u shpreh.

(Top Channel, 26 nëntor)

Merkel ka humbur, Horst Seehofer po ashtu, Martin Schulz as që bëhet fjalë. Të tre të goditur nga zgjedhjet, por ende vazhdojnë të drejtojnë partitë. Një vështrim për humbësit që nuk duan të largohen nga skena politike. Një temë e njohur për sipërmarrjet familjare të nivelit të mesëm - kreu i firmës, që me kohë i ka lënë të 70-t nuk do të ikë nga posti. Edhe në shoqatat gjermane tradicionale të korit të burrave gjen 80 vjeçarë që megjithë zërin e holluar nga vitet nuk duan që nuk duan të largohen. Në politikë shpesh mosha nuk është kriter, por më shumë kohëzgjatje në një post. Sepse një pozicion publik është i përcaktuar në kohë. Situata bëhet problematike, kur sukcesi mungon, dhe personi në detyrë nuk largohet. Horst Seehofer, kreu i partisë kristiansociale, CSU është një rast i tillë.

(DW, 26 nëntor)

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, sot ka bërë homazhe për nder të 28 Nëntorit - Ditës së Flamurit. Haradinaj ka bërë homazhe te varri i ish-presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova, në Velani, para shtatores së Zahir Pajazitit, sheshi "Zahir Pajaziti", në Prishtinë, si dhe te varrezat e Familjes Jashari, në Prekaz.

(Klan Kosova, 26 nëntor)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

SA E VJETËR ËSHTË BESA?

Vështirë të japim një përcaktim kohor për Besën. Historikisht Besa te shqiptarët ka përfaqësuar dy anë të lidhura: një virtyt moral dhe një institut i së drejtës së trashëguar. Besa ishte formë detyrimi për të ruajtur nderin, "fytirën", për të mos u veçuar, përndryshe malësori humbiste burrërinë, për buzeje nga shoqëria e miqtë. Në mendësinë popullore, mbajtja e besës barazohej me burrërinë, me nderin,

me trimërinë. Fjalë të urta shumë të urta popullore si "Burri mbahet për fjalësh, e demi për brirësh", "Shqiptari kur jep fjalën, ther djalin" etj, dëshmojnë se është një dukuri shumë e hershme. Mbajtja e fjalës së dhënë ose "fjala e nderit" për të zbatuar medoemos një detyrim të marrë përsipër, ka luajtur rol të fortë si mjet lidhës shoqëror, krahinor e ndër-krahinor. Sot, Besa, në marrëdhëniet e reja shoqërore e botëkuptimore ka funksion vetëm moral dhe është një nga virtytet e çmueshme të Njeriut.





Pa frikë nga negociatat me Greqinë

Shkup, 26 nëntor - Maqedonia nuk guxon të ketë frikë dhe të hyjë në negociata për emrin me besim të mirë, në tentimin që t'i tejkalojë dallimet, thotë ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov në një intervistë televizive për Radio Evropa e Lirë (REL). "Nuk do të negociojmë nga frika dhe nuk mund të dalim me vendim që do të na i mbulojë shqetësimet kryesore. Duhet të gjejmë zgjidhje që të dyja palët të dalin me ndjenjën se e kanë mbrojtur më të rëndësishmen", thekson Dimitrov. Në pyetjen deri ku është e gatshme të shkojë Qeveria dhe nëse edhe nga pala greke do të ketë reciprocitet gjatë ndryshimit eventual të emrave të autostradës, të monumenteve dhe revizion të librave, informon se për këtë çështje në Qeveri nuk kanë biseduar. "Kyçe është që të kuptohemi se patriotizmi do të thotë kujdes për shtetësinë dhe se është kyçe të ndërmerren argumentet e atyre forcave politike në Greqi që kanë interes ta mbajnë bllokadën. Në thelb edhe në deklaratën e Koxias është implikuar se ky do të jetë proces i dyanshëm", thotë Dimitrov për REL. Sipas tij, kërkesa e KOM deri te Kisha ortodokse bullgare që të bëhet kishë-nënë dhe si kjo do të pasqyrohet ndaj bashkëpunimit rajonal, fqinjësisë së mirë dhe pozitive të Maqedonisë, është çështje për autoritetet kishtarë dhe rezistencën e tyre që të sigurohet autoqefalia. Dimitrov thekson se nuk ka angazhim rreth kësaj çështje dhe përkujton se shteti është i ndarë nga kisha.

SHKAKU I AKTIVITETEVE TË NGJESHURA PARLAMENTARE NË FUNDVIT



LIGJI PËR GJUHËT

PRET FUNDIN

E JANARIT

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 26 nëntor - Se Ligji për gjuhët nuk do të miratohet në fund të këtij viti, ashti siç premtoi ditë më parë zëvendëskryeministri për çështje evropiane, Bujar Osmani, por do të pritët fundi i janarit të vitit të ardhshëm, e konfirmon për gazetën KOHA kryetari i Komisionit parlamentar për çështje evropiane, Artan Grubi. Shkak për këtë shtyrje, sipas Grubit, janë aktivitetet e ngjeshura parlamentare, që nga debati për buxhetin, miratimi i ligjeve prioritare për gjyqësorin e deri tek fjalimi vjetor i presidentit Gjorgje Ivanov. "Të hënën fillohet me debatin për Buxhetin që merr kohë deri në dy javë, duhet të zgjedhjet prokurori i ri, do ti jepet prioritet ligjeve që prekin reformat në gjyqësor, gjithashtu do të votohet për emrat e rinj në dikastere qeveritare, si dhe fjalimi vjetor i presidentit Ivanov. Sipas parashikimeve të mia, Ligji për gjuhët do të pres janarin - fundin këtij muaji që të miratohet plotësisht më të cilin ligj edhe do të zgjidhet një problem i kamotshëm për përdorimin e shqipes në institucionet shtetërore", theksoi Grubi. Sa i përket amendamenteve të propozuara nga LSDM, Grubi tha se dinamika e parlamentare është e kufizuar për ligjet me shenjen e BE-së, me çka sipas tij, shtyrja e mëtutje-

shme nuk do të ndodh. Në pyetjen nëse LSDM kërkon të relativizohet paragrafi 2 i nenit 1 të Ligjit për gjuhët, kur gjuha shqipe është gjuhë zyrtare në të gjitha organet e pushtetit shtetëror siç po flitet ditëve të fundit, Grubi thotë se LSDM nuk ka pse ta kërkojë një gjë të tillë kur dihet se, siç u shpreh ai, ajo ka nënshkruar një marrëveshje për bashkëqeverisje ku si kusht kryesor është Ligji për gjuhët. "Ishte marrëveshja mes BDI-së dhe LSDM-së pikërisht në lidhje me ligjin për gjuhët që e solli në jetë këtë bashkëqeverisje. Tani LSDM nuk ka pse të ndërhyjë me amendamente kur e di shumë mirë se dinamika procedurale e ligjeve me shenjen e BE-së nuk premtan se ato do të kalojnë. E them këtë pasi debati në Komisionin për çështje evropiane është i kufizuar në tre ditë dhe nëse harxhohet koha pa kaluar asnjë amendament, nuk ka debat për amendamente në lexim të dytë, por vetëm diskutime për Ligjin dhe kjo nuk mund të merr shumë kohë", theksoi Grubi. Mbledhjen e Komisionit për çështje evropiane deputeti i BDI-së do ta thërras deri të premten apo në fillim të javës tjetër. Ndërkaq në lidhje me deklaratat e kryeministrit Zaev se gjuha shqipe nuk do të jetë zyrtare në të gjithë territorin e vendit, Grubi tha shkurt se "nga gjuha shqipe askush nuk



AGRIM GASHI

Me këtë Ligj nuk bëhet zyrtarizmi, por vetëm avancimi i përdorimit të gjuhëve tjera. Dhe tjetra, ky Ligj është në kundërshtim me Deklaratën e përbashkët të partive politike shqiptare

duhet të ketë frikë, e as kryeministri". Ai hodhi poshtë pretendimet e koordinatorit të grupit parlamentar të LSDM-së, Tomislav Tuntev, se për amendamentet e propozuara ka harmonizim paraprak me deputetët e BDI-së. Ndryshe, nga Lëvizja BESA, deputeti Afrim Gashi thotë se ky propozim-ligj nuk i përmbush aspiratat e popullit shqiptar në Maqedoni për gjuhën shqipe dhe po ashtu bie ndesh me Deklaratën e Tiranës të nënshkruar mes partive shqiptare. "Ligji, i cili ka ardhur si propozim nga Qeveria e që lidhet me përdorimin e gjuhës shqipe dhe që kaloi në leximin e parë në Parlament, aspak nuk përmbush aspiratat e fundit që kanë shqiptarët në lidhje me përdorimin e gjuhës shqipe në Maqedoni. Me këtë Ligj nuk bëhet zyrtarizmi, por vetëm avancimi i përdorimit të gjuhëve tjera. Dhe tjetra, ky Ligj është në kundër-

Shkak për këtë shtyrje, sipas Grubit, janë aktivitetet e ngjeshura parlamentare, që nga debati për buxhetin, miratimi i ligjeve prioritare për gjyqësorin e deri tek fjalimi vjetor i presidentit Ivanov

shtim me Deklaratën e përbashkët të partive politike shqiptare ku ndër të tjera, në raport me gjuhën shqipe - jemi dakorduar që: Arritja e barazisë së plotë gjuhësore, përdorimi i gjuhës shqipe në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe garantimi i përdorimit të saj si e drejtë themelore dhe kushtetuese. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë duhet të përcaktojë se 'gjuha maqedonase me alfabetin cirilik dhe gjuha shqipe me alfabetin e saj janë gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë', tha për gazetën KOHA, Afrim Gashi, koordinatori i grupit parlamentar të Lëvizjes BESA. Ai ka vërejtje qysh në emërtimin e këtij Ligji, kur shqipja siç, tha Gashi, barazohet me gjuhët e pakicave tjera, ndërsa gjuha maqedonase me propozim-ligjin aktual mbetet gjuha vetme zyrtare në Maqedoni.

Ministrat e rinj deri në fund të muajit

Shkup, 26 nëntor - Kryeministri dhe lider i LSDM-së, Zoran Zaev, mbrëmë, në Këshillin qendror (KQ) të partisë, shprehu pritje se deri në fund të muajit do të sillen vendime për plotësimin e zgjedhjeve të nevojshme kuadroviqe, për vendet vakante pas zgjedhjeve lokale. Zaevi, paraprakisht, gjatë ditës, pas nënshkrimit të marrëveshjeve për mbështetje të bujqve të rinj në MBPEU, tha se deri në fund të nëntorit me

siguri do të dihen ministrat e rinj të Shëndetësisë dhe të Investimeve të huaja. Siç kumtoi LSDM-ja, Zaevi i informoi anëtarët e KQ-së për bisedat politike në këtë drejtim me një pjesë të partnerëve të koalicionit. "Treguam se jemi të suksesshëm në politikën e jashtme, ndërsa këtë do ta tregojmë edhe në planin e brendshëm përmes realizimit të programit që bart jetë për të gjithë. Qasja e ndershme dhe ekonomike do të

vazhdojë edhe në nivel lokal", theksoi Zaev në fjalimin e seancës së katërt të Këshillit qendror të LSDM-së në të cilën është miratuar Raporti për Zgjedhjet lokale 2017 të parashtruar nga Shtabi qendror i zgjedhjeve. Në Raport konstatohet se qytetarët i kanë njohur qasjen e ndershme, punën ekonomike dhe zbatimin e politikave në interes të tyre dhe vlerësohet gatishmëria e LSDM-së që besimin e dhënë ta orientojë në

realizimin e reformave për jetë për të gjithë. "Mbështetjen që e morën në këto zgjedhje korrekte dhe demokratike e tregoi saktësinë e politikave dhe përcaktimin e qartë të LSDM-së për reforma, integrimin euroatlantik dhe standard më të lartë të jetesës. Kjo mbështetje është obligim shtesë për ne që të vazhdojmë të punojmë edhe më shumë të përkushtuar, në dobi të të gjithë qytetarëve", potencoi Zaev para anëtarëve të KQ-së. Kë-

shilli qendror i LSDM-së mbrëmë solli Vendim për shpalljen e zgjedhjeve të brendshme të organeve dhe bartësve të funksioneve në organizatat komunale të LSDM-së dhe organizatat qytetare të LSDM-së-Shkup. Procedura për zgjedhjen e organeve dhe bartësve të funksioneve në organizatat komunale të LSDM-së dhe organizatës qytetare - Shkup fillon sot, 27 nëntor, ndërsa përfundon para fundit të vitit 2017.

Buxheti 2018 me karakter reformator

Shkup, 26 nëntor - Nga të gjitha buxhetet deri më tani, i propozuari për vitin 2018 ka karakter më reformator dhe më ekonomik. Është determinuar nga nevojat e qytetarëve sepse mbi 60 për qind e tyre janë deklaruar se prioritet i parë që pritet nga Qeveria është përmirësimi i klimës ekonomike, deklaroi pasdite në konferencën për shtyp në Qeveri, zëvendëskryeministri i obliguar për Çështje Ekonomike Koço Angjushev, duke i prezantuar zërat ekonomikë në Propozim-buxhetin për vitin e ardhshëm. Ai është 211.7 miliardë denarë ose 3,4 miliardë euro dhe duhet të sigurojë të paktën 3,2 për qind rritje të BPV-së. Deficiti është projektuar prej 2,7 për qind me tendencë të uljes. Angjushev theksoi se me buxhetin duhet të sigurohet stabilitet në vend, të nxitet zhvillimi dhe të bëhet sistemim i drejtë i parave të popullit dhe prandaj, tha, esenca është se do të tentojmë t'i shkurtojmë të gjitha shpenzimet joproductive të cilat nuk sjellin kurrfarë beneficioni për popullin. Për investime kapitale me të cilat duhet të përmirësohet jeta e qytetarëve janë planifikuar 24 miliardë denarë ose më shumë se 400 milionë euro: 3,5 miliardë euro për infrastrukturë rrugore dhe hekurudhore, 5,9 miliardë denarë për infrastrukturë komunale dhe energjetike, 405 milionë denarë për investime në ZZHTI, 2,4 miliardë denarë për arsim dhe sport, 1,9 miliardë denarë për shëndetësi, 1 miliardë denarë për mbrojtje, 531 milionë denarë në gjyqësi dhe 917 milionë denarë për rendin dhe sigurinë publike. Drejtpërdrejt në ekonomi, tha zëvendëskryeministri, janë determinuar 4,1 miliardë denarë, të cilat janë për programe lidhur me Planin për rritje ekonomike dhe në mënyrë shtesë për nxitjen e punësimit. Rritja në Programin për zhvillim ekonomik në tërësi - për masa ekonomike dhe përmirësim të ekonomisë në shtet është 46 për qind në lidhje me ribalansin e Buxhetit për vitin 2017. "Me këtë buxhet, Qeveria e Republikës së Maqedonisë dëshiron të tregojë se është e orientuar drejt zhvillimit të investimeve kapitale, zhvillimit ekonomik dhe përmirësimit të jetës së çdo qytetari në vend, se është e vendosur të vlerësojë në mënyrë të barabartë investuesit vendas dhe të huaj. Ne po luftojmë për paga më të larta për të gjithë punëtorët dhe për një standard më të lartë jetese", tha zëvendëskryeministri për Çështjet Ekonomike.

SOT FILLON DEBATI PËR PROPOZIM-BUXHETIN 2018



BUXHETI I PAGAVE

Të ardhurat e përgjithshme për vitin e ardhshëm janë më të mëdha për 4.7 për qind në raport me këtë vit, ndërsa të ardhurat për 4.1 për qind

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 26 nëntor - Në Parlament, sot fillon debati për propozim-buxhetin për vitin 2018. Buxheti i propozuar është në rend dite në Komisionin amë për financim dhe buxhet, ku sipas rregullores debati zgjatë 10 ditë pune. Të ardhurat e përgjithshme për vitin 2018 planifikohen në nivel prej 193.512 milionë denarë, ndërsa shpenzimet planifikohen në nivel prej 211.745 milionë denarë, gjegjësisht 3.4 miliardë euro. Kështu të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara rezultojnë me uljen e deficitit buxhetor në nivel prej 2.7 për qind nga BPV-ja ose 18.233 milionë denarë në vlerë absolute. Do të financohet nga borxhi vendor dhe i jashtëm dhe me qëllim që borxhi të jetë i ulët, rritet akciza e naftës për tre denarë nga 1 janari i vitit 2018. Ky nivel i deficitit, sipas Qeverisë, pasqyron vendosmërinë për konsolidim gradual fiskal si rezultat i kontrollit të rreptë dhe disiplinës së fuqishme buxhetore gjatë reduktimit të shpenzimeve joproductive, duke siguruar një sasi të konsiderueshme të investimeve kapitale dhe subvencioneve për të mbështetur ekonominë vendore, të cilat do të sigurojnë përmirësim në performancat ekonomike. Të ardhurat e përgjithshme për vitin e ardhshëm janë më të mëdha për 4.7 për qind në raport me këtë vit, ndërsa të ardhurat për 4.1 për qind. Me buxhetin e propozuar parashikohen investime kapitale, për

pagesë në kohë dhe pa pengesa të rrogave, pensione, transfertave sociale, mbështetjes së kompanive vendore. Nga tatimet janë planifikuar të mblidhen 114.979 milionë denarë, që është për 7.5 për qind më shumë se këtë vit. Nga kontributet priten 55.403 milion denarë, që është pesë për qind më shumë se këtë vit. Kjo rritje është nga lëvizja e pritit e ekonomisë, duke rritur punësimin dhe pagat e punonjësve.

Nga shpenzimet në total, gjegjësisht për shpenzimet rrjedhëse do të shkojë 187.100 milionë denarë, për paga dhe kompensime 27.103 milionë denarë të cilat janë për 1.8 për qind më të larta se këtë vit, për mallra dhe shërbime 17.463 dhe ato janë më të ulëta me 1.1 për qind. Më shumë para do të transferohen në komunitet për 5.2 për qind apo 17.947 milionë denarë, për 10.5 për qind krahasuar me këtë vit është rritur shkalla e subvencioneve dhe transfereve për çka janë paraparë 17.209 milionë denarë, rritje prej 4.1 për qind dhe te transferet sociale të cilat vitin e ardhshëm janë projektuar në 98.694 milionë denarë dhe 5.3 rritje për qind rritje ka te shpenzimet kapitale të cilat janë projektuar në 24.645 milionë. Shteti më së shumti, gjegjësisht 32 për qind, ndan për mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve, 19 për qind për zhvillimin ekonomik dhe financiar, 14 për qind për shëndetësi, 11 për qind për arsimin, shkencë dhe sport, 5 për qind për ndërtim, transport, komunikim dhe ekologji dhe për rendin dhe sigurinë publike, tre për

qind për mbrojtjen, dy për qind për punët e jashtme, integrimin në BE dhe për kulturë dhe nga një për qind nga buxheti i përgjithshëm parashikohen për gjyqësi dhe zhvillim rajonal. Qeveria ka në plan të zvogëlojë fondet për shpenzimet joproductive. Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë projektuar në shumën prej 17.463 milionë denarë, që siguron zgjidhje të rregullt dhe të papenguar të detyrimeve të përdoruesve të buxhetit, duke përfshirë sigurimin e fondeve për financimin e programeve shëndetësore me qëllim të përparimit të shëndetit dhe përmirësimit e kujdesit shëndetësor të popullsisë. Për mallrat dhe shërbimet vitin e ardhshëm shteti do të shpenzojë më pak para për 203 milionë denarë krahasuar me këtë vit. Do të shpenzohen më shumë fonde për shpenzime kapitale, të cilat janë projektuar në nivelin prej 24.645 milionë denarë, të destinuara për intensifikimin e projekteve të infrastrukturës, gjegjësisht për investime për përfundimin e Korridorit 10 dhe infrastrukturën hekurudhore, infrastrukturën e energjisë dhe komunale, si dhe investime kapitale për përmirësimin e kushteve në sistemet shëndetësore, arsimore dhe sociale, bujqësi, kulturë, sport, mbrojtje të mjedisit dhe gjyqësi.

Për infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore është paraparë një shumë prej 3.506 milionë denarëve, në infrastrukturën energjetike dhe komunale 5.778 milionë denarë për sektorin e shëndetësisë janë planifikuar investimet në shumë prej 1.859 milionë denarë,



Në Buxhet janë paraparë dhe rritje të pagave për 10 për qind për pjesëtarët e ARM-së dhe pesë për qind për personelin e arsimit dhe kopshtit, si dhe punëtorët shëndetësorë

investimet e planifikuara në sektorin e shëndetësisë janë parashikuar në një shumë prej 1.859 milionë denarë në arsim, mbrojtjen e fëmijëve dhe sport 2.440 milionë euro, për të mbështetur sektorin e bujqësisë, është paraparë rritja e vëllimit të investimeve kapitale në 2.604 milionë denarë edhe në fushën e drejtësisë janë planifikuar mjete në vlerë prej 544 milionë denarë. Në Buxhet janë paraparë e dhe rritje të pagave për 10 për qind për pjesëtarët e ARM-së dhe pesë për qind për personelin e arsimit dhe kopshtit, si dhe punëtorët shëndetësorë. Mjetet e përgjithshme të projektuara për pagat në Projekt-buxhet janë 27.103 milionë denarë. Për pensionet janë paraparë 54.000 milionë denarë, të cilat anë të destinuara për pagesën e pensioneve, që përfshin harmonizimin e parashikuar ligjor të pensioneve me rritjen e pagave dhe shpenzimet e jetesës.

52.539 MILIARDË DENARË SHTETI DO MARRË HUA

Vitin e ardhshëm, shteti planifikon të marrë hua gjithsej 52.539 miliardë denarë në tregun e brendshëm dhe atë të huaj. Në tregun e brendshëm, shteti parashikon të huazojë 17.7 miliardë denarë, ndërsa në tregun e huaj 34.839 miliardë denarë. Përveç huamarrjes, shteti planifikon të rrisë shumën prej 12,246 milionë denarë për pagesat e borxheve të brendshme dhe 10,418 milion denarë për pagesën e huave të

huaja. Në pagesa në bazë të huave të brendshme, vitin e ardhshëm ka 31 për qind më shumë, ndërsa te huat e huaja pagesa është më e lartë për 15 për qind. Me propozim-buxhetin parashihet që ekonomia e Maqedonisë vitin e ardhshëm të ketë një rritje prej 3.2 për qind dhe normën e inflacionit prej 1.7 për qind. Sipas tekstit të propozuar, janë parashtruar gjithsej 239 amendamente.

PROKURORIA E KUMANOVËS TENTON TA SHPËTOJË BOBAN ILIQIN



VRASJE E DYFISHTË E 4-VJEÇARIT

"Në këtë fazë të procesit gjyqësor, kur jemi para dhënies së fjalëve përfundimtare, për ne është e papranueshme që kjo veprë penale të ndryshohet. Të gjitha dëshmitë verbale dhe materiale të prezantuara deri më tani tregojnë qartë se bëhet fjalë 'vrasje me paramendim'. Mirëpo, prokuroria vazhdon të bëhet e shurdhër ndaj provave tona", ankohe avokati Alispahiç

Koha Omer XHAVERI

Shkup, 26 nëntor - Tendencë që vrasja e vogëlushit Almir Aliu të gjykohej si "aksident rrugor me pasojë vdekjen", është hap politik i Prokurorisë së Kumanovës dhe aspak profesional, juridik dhe gjyqësor. Përfaqësuesi ligjor i familjes Aliu, avokati Asmir Alispahiç, në një prononcim për gazetën KOHA, për të satën herë me radhë shpreh shqetësimin e tij për tentimet e prokurorisë në rastin "Almir Aliu", që ky rast të relativizohet, me qëllim vrasësi Boban Iliq, të sanksionohet me dënime më të ulëta të mundshme. Pala mbrojtëse e kryesuar nga avokati Alispahiç, është e palëkundshme në qëndrimin se veprimet e të akuzuarit, në tërësi përputhen me veprën penale "vrasje me paramendim".

"Prej fillimit e kemi shprehur shqetësimin tonë se prokuroria nuk vepron komfor dispozitive ligjore. Ajo, në mënyrë të qartë tregon se të akuzuarit kryesor tentohet t'i ndihmohet. Kërkesa për rikualifikimin e veprës është e drejtë e palës mbrojtëse, megjithatë ajo duhet të bëhet me arsye të fortë. Në këtë fazë të procesit gjyqësor, kur jemi para dhënies së fjalëve përfundimtare, për ne është e papranueshme që kjo veprë penale të ndryshohet. Të gjitha dëshmitë verbale dhe ma-

teriale të prezantuara deri më tani tregojnë qartë se bëhet fjalë 'vrasje me paramendim'. Mirëpo, prokuroria vazhdon të bëhet e shurdhër ndaj provave tona", thotë avokati Alispahiç. Në rast të rikualifikimit të veprës, atëherë siç thonë avokatët mbrojtës, ekziston mundësia që vrasësi Iliq të dënohet me burg deri në 4 vite, respektivisht në rast të ankimit të këtij dënimi, ai mund të lirohet edhe nga paraburgimi. Sistemi gjyqësor i kapur, skajshmërisht i politizuar, jo transparent dhe i padrejtë, kur bëhet fjalë për lëndë gjyqësor ndaj shqiptarëve, pritet të vërtetohet edhe në procesin zbardhjes së vrasjes së vogëlushit Almir Aliu, i cili në qershor të vitit 2016 në mënyrë brutale, me paramendim u godit nga vrasësi Boban Iliq.

Praktika gjyqësore e deritanishme, kur bëhet fjalë për proces gjyqësor kundër shqiptarëve, apo siç është rasti kur viktimat janë shqiptarë, është mirë e njohur për opinionin vendas, por edhe atë më të gjerë. Ekspertet juridik dhe avokatët, mes tjerash thonë se anshmëria e sistemit juridik në vend mund të analizohet përmes dënimeve që ju jepen të akuzuarve shqiptarë në procese gjyqësore, respektivisht në të gjitha lëndët gjyqësore atyre ju shqiptohet dënime maksimale. Përderisa kur flasim për të aku-

zuarit tjerë, praktika gjyqësor dëshmon se këto dënime zakonisht janë tejet më të ulëta. Shembujt më të mirë që e përshkruajnë këtë situatë të brishtë janë dënime për protestuesit e rastit "Monstra", të cilët në vitin 2014 u dënuan me sanksione maksimale me nga 3 vite heqje lirie. Aktgjykim tjetër politik, për të cilën opinioni vendas ishte dëshmitar i një padrejtësie, e cila pati pasojë ndaj shqiptarëve edhe më pas, ishte dënimi i Naser Eshtrëfit nga fshati Gërçec i Sarajit, i cili edhe pse në vetëmbrojtje, ai megjithatë nga Gjykata Penale e Shkupit u dënua me 14 vite burg për "vrasje" të maturantit Angel Petrovski. Qëllimin e rikualifikimit të vrasjes së Almir Aliut, sipas burimeve të gazetës KOHA, prokuroria e rastit Suzana Kusigerska, orvatet ta realizojë përmes kryeprokurorit të Kumanovës, Goran Peshevski, të cilit i ka skaduar mandati i fituar në kohën kur në pushteti ishte VMRO-DPMNE.

Profesori universitar, Bashkim Selmani, duke komentuar procesin gjyqësor kundër vrasësit të Almir Aliut, thotë se sistemi gjyqësor në vendin tonë është dëshmuar se nuk korrespondon me tre organet bazë për zbardhjen e së vërtetës (MPB-Prokuroria-Gjykata), por këto janë dirigjime politike me pasojë të lehta për maqedonasit dhe me pasojë jashtë mase të rënda për shqiptarët, pavarësisht se bëhet fjalë për të akuzuar apo të dëmtuar. "Jo rastësisht vërejtjet dhe rekomandimet e Pribes

vijnë në këtë konotacion. Tre institucionet kyçe që kanë autonomi të pavarur për ta zbardhur dhe për ta dëshmuar të vërtetën, pikërisht këto janë ato organe që i fshihin gjurmët dhe bëjnë rikualifikime në baza nacionale, në interes të maqedonasit dhe politikës së tyre. Roli i policisë në këto rast fillon nga inicimi i kallëzimit penal, të cilët veprën e kanë kualifikuar si të tillë. Më pas vjen Prokuroria, e cila ka kompetenca dhe funksion për të kërkuar shqiptimin e dënimeve maksimal për të gjithë kryerësit e veprave penale. Gjyqësori tek ne është një pushtet i dështuar, këtë e kanë të qartë të gjithë. Shkeljet më të shpeshta vijnë nga keqbërësit brenda policisë, prokurorisë apo gjyqësorit. Fatkeqësisht, kjo vazhdon të ndodhë kur në pozita udhëheqëse janë ministrat shqiptarë, të cilët në procedurat parahetimore, ato hetimore apo në fazat e procedurave gjyqësore - ata kanë mundësi dhe të drejtë që të kërkojnë revizion të punës. Dhe, nëse gjatë këtyre revizioneve vërtetohet se ekzistojnë kualifikime të veprave me karakter nacional, atëherë prokurori i lëndës mund të zëvendësohet me tjerë dhe ndaj tyre të hapet procedurë penale", tha profesori Selmani për gazetën KOHA. Ai mes tjerash shtoi, se në këtë rast, familja e të ndjerit Almir Aliu, duhet të iniciojë padi private ndaj prokurorit, nën dyshimet e "keqpërdorimit të detyrës zyrtare". Në kohën kur proceset gjyqësore zhvillohen në mënyrë jo transparente, profesori Selmani tha se shqiptarët në përgjithësi duhet ti kenë parasysh të drejtat që ua jep Ligji për procedurë penale. Pjesë e dispozitive të këtij ligji, siç tregon ai, janë edhe mundësit që pala e dëmtuar apo ajo e akuzuar të iniciojë padi kundër prokurorit, me arsyetim të mos marrjes parasysh dhe shkeljes së provave "pro" procesit gjyqësor.

KRONIKË

Edmon Temelko në arrest shtëpie

Pas miratimit të mendimit pozitiv nga Prokuroria Speciale Publike (PSP), paraburgimi i Edmond Temelkos u zëvendësua me masën arrest shtëpie, konfirmuan për MIA-n nga Gjykata Penale. Temelko u arrestua para dy muajve me kërkesë të PSP-së sepse ishte i akuzuar në lëndën për parregullsitë zgjedhore "Titanik", ndërsa nuk e ka respektuar masën e ndalesës për largim nga vendi.

Dy nëna braktisin foshnjat në Gjinekologjinë e Shkupit

Dy lehona nga Prilepi këtë javë pas lindjes i kanë lënë foshnjat e tyre në Gjinekologjinë e Shkupit. Në rastin e parë bëhet fjalë për gruan që iu dërgua hamburger të dyshuar sipas gjitha gjasave në të kishte drogë, e cila gjatë daljes nga spitali ka thënë se ndoshta kthehet për ta marrë foshnjën. E dyta, që e lëshoi spitalin, ka qenë e vendosur në vendimin që ta braktis fëmijën ta merr ndokush për përkuqdesje kush ka nevojë. Në gjinekologji foshnjat i mbajnë derisa të stabilizohen me shëndet, pastaj i dërgojnë në shtëpinë për fëmijë të vegjël në Manastir. Këtë vit edhe shtatë nëna që kanë lindur në Gjinekologjinë e Shkupit kanë hequr dorë nga foshnjat, vitet e kaluara shumë rrallë ndodhte që nëna pasi ka braktis fëmijën të kthehet ta marrë foshnjën e lënë.

Aksidentohet për vdekje këmbësori në Gostivar

Të shtunën, rreth orës 13 e 45 minuta, në bulevardin "Goce Delçev" të Gostivarit, B.Q 66 vjeçar, duke drejtuar automjetin Fiat Tempra, me targa të Gostivarit, ka aksidentuar drejtuesin e një biçiklete A.R 73 vjeçar nga fshati Çajle. Pas aksidentit, 73 vjeçari është dërguar në Spitalin e Gostivarit, ku i janë konstatuar lëndime trupore, por pasi që nuk është ndjerë mirë është mbajtur për kurim të mëtejshëm. Pas një kohe të shkurtër, ai është transferuar në Klinikat e Shkupit, ku të dielën në mëngjes ka ndërruar jetë. Hetim në vendin e ngjarjes kanë kryer ekipet e Stacionit Policor në Gostivar, ndërsa me urdhër të Gjykatës hetues mbi trupin e pajetë të të ndjerit do të kryhet obduksion. (u.h)

FAJTOR EDHE ZYRTARËT SHQIPTARË TË DREJTËSISË

"Shkeljet më të shpeshta vijnë nga keqbërësit brenda policisë, prokurorisë apo gjyqësorit. Fatkeqësisht, kjo vazhdon të ndodhë kur në pozita udhëheqëse janë ministrat shqiptarë, të cilët në procedurat parahetimore, ato hetimore apo në fazat e procedurave gjyqësore - ata kanë mundësi dhe të drejtë që të kërkojnë revizion të punës. Dhe, nëse gjatë

këtyre revizioneve vërtetohet se ekzistojnë kualifikime të veprave me karakter nacional, atëherë prokurori i lëndës mund të zëvendësohet me tjerë dhe ndaj tyre të hapet procedurë penale", tha profesori Bashkim Selmani për gazetën KOHA.



KOMITETI I HELSINKIT REAGON PËR SHKELJET E DISPOZITAVE TË LPP-së

GJYKATA PO BËHET PALË ME PROKURORËT

Pyetjet jokoncize dhe formulimet e paqarta nga prokurorët, rregulla këto të cilat prokurorët janë të obliguar t'i respektojnë, për shkak se vetë LPP-ja parasheh një gjë të tillë, sipas monitoruesve të KH, shpeshherë para se të shënohen në procesverbale, ato korrigjohen nga Trupit gjyqësor

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 26 nëntor - Procesverbalet në procedura penale edhe më tej përpilohen nën diktimin dhe dirigjimin e gjykatësve. Kjo vërejtje është përfshirë në raportin e fundit të Komitetit të Helsinkit, të cilët përmes monitorimit të proceseve të ndryshme gjyqësore, me theks të veçantë ato që zhvillohen para Gjykatës Penale të Shkupit, kanë konstatuar se dispozitat e Ligjit për procedurë penale (LPP) nuk zbatohet siç duhet në praktikë. Mos futja në praktikë e LPP-së, normat e së cilës janë në fuqi për pesë vite të plota, sipas Komitetit të Helsinkit, është konstatuar edhe gjatë parashtrimit të pyetjeve të drejtpërdrejta dhe atyre të kryqëzuara ndaj dëshmitarëve. "Me largimin e të ashtuquajturit paternalizëm gjyqësor dhe me kalimin në procedurë akuzuese, konform LPP-së, Gjykata si palë e ka humbur rolin me të cilin duhej ta konstatojë të vërtetën materiale, respektivisht me dispozitat e reja ligjore, barra për vërtetimin e fajit apo pafajësisë, tashmë bie mbi palët në proces gjyqësor (prokurorët dhe avokatët). Kjo nënkupton se prokurori - një lëndë të caktuar duhet ta përgatisë në mënyrë të detajuar dhe më pas, me shkathtësi ta realizojë procedurën e parashtri-

mit të pyetjeve", thuhet në raportin e Komitetit të Helsinkit. Me qëllim mënjanimin e lëshimeve që bëhen gjatë përgatitjes së procesverbale, në LPP, i cili është në fuqi prej vitit 2013, qëndron se seancat kryesore gjyqësore të xhirohen në formë audio ose video-vizuale. Mirëpo, nga prezenca e mediave dhe opinionit në seanca gjyqësore, mund të thuhet se kjo mënyrë e procedimit të seancave gjyqësore, zbatohet pjesërisht.

"Përparësitë, të cilat i japin këto nene (për xhirimet e seancave audio apo video), apo përmes përgatitjes së procesverbaleve me stenogramme, mundësojnë evidencë të detajuar dhe pa asnjë farë lëshimi të çdo ngjarjeje që ndodhë gjatë seancave kryesore. Me këtë rast, po ashtu pengohen lëshimet eventuale që mund të ndodhin gjatë futjes së të dhënave në përmbajtjen e procesverbaleve", theksohet në raportin e Komitetit të Helsinkit. Mes tjerash, vërejtje tjetër sa i përket zhvillimit të seancave gjyqësore, nga Komitetit të Helsinkit i kanë potencuar lëshimet e prokurorëve, lëshi-

me këto që kryesisht vijnë në shprehje gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve. Pyetjet jokoncize dhe formulimet e paqarta nga prokurorët, rregulla këto të cilat prokurorët janë të obliguar t'i respektojnë, për shkak se vetë LPP-ja parasheh një gjë të tillë, sipas monitoruesve të KH, shpeshherë para se të shënohen në procesverbale, ato korrigjohen nga Trupit gjyqësor. Gjykatësit dhe prokurorët, siç rekomandojnë nga Komiteti i Helsinkit, janë të detyruar t'i respektojnë dispozitat që burojnë nga LPP-ja, gjegjësisht ndonëse vërejtjet e konstatuara nga ana e tyre mund të jenë "banale", kur jemi te përgatitja e procesverbaleve apo mënyrë e marrjes në pyetje e dëshmitarëve, megjithatë këto lëshime mund të ndikojnë në shkeljen e parimit të realizimit të drejtë të procedurës penale. Shembuj konkrete të mos respektimit të LPP-së, gazetarët dhe përfaqësuesit e sektorit civil, po edhe të vetë përfaqësues të ambasadave të huaja, së fundmi kanë pasur mundësi t'i shohin gjatë procesit gjyqësor për "Lagjen e Trima-

ve", ose në seanca gjyqësore ku si palë është paraqitur Prokuroria Speciale Publike. Të akuzuarit për rastin e "Kumanovës", përgjatë gjithë procesit gjyqësor që u zhvillua kundër tyre, në mesin e reagimeve dhe kundërshtimeve më të shpeshta e kanë pasur mospërfshirjen e fjalëve të tyre në procesverbal. Në kuadër të këtij rasti, ato shpesh janë ankuar edhe ndaj përkthimit dhe mos përgatitjes së kuadrit të mirëfilltë i cili e njeh terminologjinë juridike nga maqedonishtja në shqip apo anasjelltas. Sidoqoftë, pavarësisht këtyre reagimeve, procesi gjyqësor për "Lagjen e Trimave", gjatë gjithë kohës, në pajtim me dispozitat e LPP-së, ka qenë i xhiruar. Ndërkohë, kur jeni te përcjellja e seancave gjyqësore të iniciuara nga PSP, opinionimi më i gjerë ka vërejtur shkelje të natyrave të ndryshme, të kryera nga vetë Trupi gjyqësor, duke filluar nga mos dhënia e materialeve xhirues prokurorëve specialë, tendencat e ndryshme që fjalimet e tyre mos të përfshihen në procesverbal e kështu me radhë.

VRASËSI I ARIFIT ENDE NË LIRI

Shkup, 26 nëntor - Dy ditë pas vrasjes së Ismet Arifit Koka, në lagjen Fushë Tophane të Shkupit, policia ende nuk ka asnjë të dhënë se kush mund të jetë realizatori i kësaj vrasjeje. Për gazetën KOHA, nga Ministria e Punëve të Brendshme thonë se ende janë duke punuar në zbardhjen e rastit dhe se pas hetimeve të plota, do të dalin me prononcim zyrtar për opinionin. Përveç të ndjerit Arifi, mbrëmjen e 23 nëntorit nga të shtëna me armë zjarri në rrugën "Ferid Murat", mbeti i plagosur edhe Qemal Lusjani. Ndryshe, në kumtesën e parë për media nga policia e Shkupit, është njoftuar se para ngjarjes tragjike, Arifi dhe Lusjani kanë qëndruar në çajtoresh "Dizeldorf". Kur kanë dalë nga ky lokal, siç njoft-

uan nga policia, të njëjtit kanë hipur në automjetin "Passat", pronë e M.S. e cila ka qenë e parkuar në afërsi çajtores. Pasi tashmë i ndjeri Ismet Arifi, është ulur në vendin e shoferit dhe Qemal Lusjani në vendin e pasagjerit, brenda disa çasteve ndaj tyre janë shkrepuar një breshëri plumbash, me çka ekspertiza e policisë ka zbuluar gjithsej 11 gëzhoja. Vrasja, e cila ndodhi ditë më parë në Çair, është regjistruar ende pa mbushur një muaj nga vrasja e cila ndodhi në lagjen Aerodrom të Shkupit, ku futbollisti Martin Janushev, në rrethana ende të paqarta, u vra nga tash personi në kërkim Filip Sekulovski. Ngecje në zbardhjen e një vrasjeje tjetër, policia e shtetit shënon edhe në likuidimin e Dilaver Bojkut nga



Struga. Përkundër faktit se ngjarja ka ndodhur tre muaj më parë, ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, ditë më parë theksoi se ende janë duke u zhvilluar hetimet për zbulimin e autorëve të kësaj vrasjeje.

Shkup, pesë vjedhje për më pak se një orë!


Shkup, 26 nëntor - Pesë vepra penale "grabitje" janë kryer të shtunën në Shkup në periudhën nga ora 18:50 deri në orën 19:30. Buletini ditor i policisë në pesë grabitjet si autorë të krimit përmend dy persona të panjohur të cilët kanë grabitur duke kërcënuar me thikë. Grabitja e parë ka ndodhur në orën 18:50 orë në bul. "Aradhet partizane" kur është kryer grabitja ndaj TG, dhe i janë marrë 300 denarë dhe i janë marrë kufjet e telefonit celular. Rreth orës 19:00 në bul. "Aradhet partizane", në afërsi të Sallës Universale, është kryer grabitje ndaj M.P. ku me kërcënim me thikë i janë paratë. Rreth orës 19:00, në ul. "Daskal Kamçe" dy persona të

panjohur me kërcënim me thikë kanë kryer grabitje ndaj S.S. dhe D.D. të cilëve u janë marrë 400 denarë dhe kanë ikur. Rreth orës 19:30 në stacionin e autobusit pranë Qendrës Tregtare Bunjakovec, dy persona të panjohur me kërcënim me thikë kanë kryer grabitje ndaj A.R. duke marrë rreth 500 denarë dhe kanë ikur. Vjedhja e pestë ishte gjithashtu në orën 19:30 në rrugë. "Ivan Kozarov", kur dy persona të panjohur me kërcënim me thikë kanë kryer grabitje ndaj tre të miturve, duke marrë 500 denarë dhe më pas kanë ikur. MPB ndërmerr masa për gjetjen e autorëve dhe për të zbardhjen e plotë të të gjitha rasteve.

FINANCIMI I UNIVERSITETEVE PUBLIKE

PËR KAMPUSIN E UNT-SË, AS GJYSMA E PREMTUAR

Nga 200.000.000 denarë apo mbi 3 milionë euro janë planifikuar të shpenzohen për vitin 2018, me qëllim të ndërtimit të kampistit universitar të Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup dhe për vazhdimin punimeve të objekteve të Universiteti "Kirili dhe Metodi" në Shkup



BUXHETI	2017	2018
Arsimi i lartë	19.794.507.000	20.863.590.000
Universiteti "Kirili dhe Metodi" Shkup	2.837.354.000	1.352.174.000 1.136.486.000-rroga
Ndërtimi i FINK dhe FKF (UKM)	250.000.000	200.000.000
Universiteti i Tetovës	374.546.000	330.346.000 275.846.000-rroga
Universiteti "Goce Dellçev" Shtip	281.340.000	270.460.000 217.160.000-rroga
Universiteti "Nënë Tereza" Shkup	81.870.000	288.388.000 50.288.000-rroga
Universiteti "Apostoll Pavle" Ohër	102.880.000	92.720.000 16.770.000-rroga
Universiteti "Klimenti i Ohrit" Manastir	267.496.000	296.421.000 249.210.000-rroga
Institucionet private joprofitabile	42.000.000	42.000.000
Botim i literaturës profesionale	76.250.000	60.124.000

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 26 nëntor - Milionat e premtuara për ndërtimin e Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, nuk janë në atë sasi sa që pritej të ndahen për vitin 2018. Ishte deklaruar disa herë se për ndërtimin e kampusit universitar të UNT-së, në hapësirat e ish-kazermës ushtarake "Ilinden", gjatë tre viteve të ardhshme do të ndahen rreth 21 milionë denarë apo për afërsisht nga 7 milionë euro secilin vit. Mirëpo, kjo sasi mjetesh mungon të paktën në buxhetin e vitit të ardhshëm kalendarik.

Për UNT-në, me buxhetin e 2018-ës parashihet të ndahen në total 288.388.000 denarë ose rreth 4.690.000 euro, duke përfshirë në këtë zë të gjitha shpenzimet e nevojshme për funksionimin e këtij universiteti. Pra, në 4.690.000 eurot e planifikuara për UNT-në, janë përfshirë, përveç mjeteve financiare për rrogat dhe kontributet e të punësuarve, për mirëmbajtje, blerjes së pajisjeve dhe mobileve dhe shpenzimeve të tjera të nevojshme, nga ai buxhet duhet të ndahen edhe mjete për ndërtimin e objektit universitar. Për këtë qëllim, në suazat e buxhetit të UNT-së, janë planifikuar mbi 3 milionë euro për ndërtimin e kampusit në vitin 2018, po aq sa edhe për ndërtimin e dy fakulteteve të Universitetit "Kirili dhe Metodi" në

Shkup, por që kanë një buxhet të veçantë. Konkretisht, për ndërtimin e objekteve të UKM-së, në buxhetin për arsim të lartë është planifikuar zë i veçantë. Kështu, vetëm për vazhdimin e punimeve për ndërtimin e objekteve për Fakultetin e Shkencave Informatike dhe Inxhinierisë Kompjuterike (FINK) dhe për Fakultetin e Kulturës Fizike (FKF) janë planifikuar 200.000.000 denarë apo 3.253.000 milionë euro. Këto mjete i janë ndarë UKM-së, krahas 1.352.174.000 denarëve (21.987.000 eurove) për shpenzime tjera të nevojshme për funksionimin e atij universiteti. Të llogaritura në total, UKM është prezent me 1.552.174.000 denarë apo 25.240.000 euro në buxhetin e përgjithshëm të arsimit të latë për vitin 2018, i cili shkon në 339.245.366 milionë euro gjithsej. Kështu, UKM merr në të njëjtën kohë tiparin e institucionit të arsimit të lartë me buxhetin më të madh në Maqedoni, duke lënë shumë prapa universitet tjera publike, si ai i Tetovës, Manastirit, Shtipit apo edhe Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup. Nga viti 2017 në vitin 2018 është shënuar rritje e lehtë e buxhetit në zërin për arsim të lartë, edhe atë nga

19.794.507.000 denarë (321.861.902 euro) në 20.863.590.000 denarë (339.245.365 euro), por vëren edhe rënie dhe ngritje të konsiderueshme nëse krahasohen zërat e njëjta. Çdo herë, sipas planifikimit nga buxheti bazë, rënie më të madhe ka buxheti i UKM-së nga rreth 46.136.000 euro (2017) në rreth 22.000.000 euro (2018). Rënie të konsiderueshme ka edhe UT-ja, nga rreth 6.100.000 euro në 5.372.000 euro, ai i Shtipit, nga 4.754.000 euro në 4.400.000 euro dhe UAP në Ohër, nga 1.673.000 në 1.500.000 euro. Rritje të buxheti ka shënuar Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup, nga rreth 1.332.000 euro në 4.690.000 euro, por për shkak të rreth 3.250.000 brenda atij buxheti dhe, po ashtu ka rritje në buxhetin e Universitetit të Manastirit nga rreth 4.350.000 euro në 4.830.000. Për institucionet private jo profitabile, nuk

është ndryshuar shuma e parave që planifikohet të shpenzohen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Pra, për vitin 2018 mbetet e njëjtë shuma e parave për këtë zë, rreth 638.000 euro, sa edhe vitin paraprak. Në planifikimet për botim të literaturës profesionale, MASH duket se është treguar pak më dorë shtrënguar se vitin e kaluar, pasi për dallim prej rreth 1.240.000 të ndara për vitin që po lëmë pas, për vitin e ardhshëm për këtë qëllim janë planifikuar të shpenzohen diçka më pak se 978.000 euro, përdërisa Akademia e Mësimdhënësve është fshirë krejtësisht nga buxheti i vitit që vjen. Në buxhetin e institucioneve të arsimit të lartë bie në sy orientimi i shpenzimeve kryesisht për rroga dhe kontribute. Kështu, te UKM-ja mbi 80 për qind e buxhetit shkon për këtë qëllim, te UT-ja 83.5 për qind, te UNT-ja rreth 57 për qind apo te UKM-ja 84 për qind. Në kuadër të buxhetit nga të hyrat bazë, institucionet e arsimit të lartë financohen kryesisht për rrogat dhe kontributet e të punësuarve. Për shpenzimet tjera u duhet shpesh herë të "prodhojnë" të holla nga buxhetet vetanake, donacionet apo edhe kyçja nëpër projekte të ndryshme.

39 asistentë që kujdesen për fushatat e Qeverisë

Shkup, 26 nëntor - Kryeministri Zoran Zaev i hodhi postë si të pasakta, informacionet gjithnjë e më të shpeshta në opinion se Qeveria deri më tani ka angazhuar 120 persona. Sipas tij, bëhet fjalë për gjithsej 39 njerëz, të cilët asistojnë tekstualisht për shkak të transparencës së punës së Qeverisë, por edhe prej tyre, siç tha, do të qëndrojnë shumë më pak.

"Bëjmë llogari për punë ekonomike, bëjmë përpjekje që me resurse minimale të japim para qytetarëve atë që duhet. Në asnjë rast nuk do të harrojmë se transparenca është punë e rëndësishme. E kotë është gjithçka që bëjmë, nëse qytetarët nuk dinë për atë. Nëse qytetarët dhe ju mediat nuk na kontrolloni, mundet secili të dalë jashtë kontrollit dhe në fund të na përsëriten punët nga e kaluara për të cilat as ne, as qytetarët nuk presim që të ndodhin. Në mënyrë të hapur, përmes rrugës së debatit biseduam për të gjitha punët, jemi të gatshëm çdoherë të korrigjohemi, por besoni se ato janë resurse minimale që na duhen për asistim, për gjithçka që është përgjegjësi shoqërore dhe qeveritare para qytetarëve, që të vijë deri tek qytetarët", tha Zaev, duke u përgjigjur në pyetje të gazetarëve pas nënshkrimit të marrëveshjeve të para për mbështetje të bujqve të rinj në Ministrinë e Bujqësisë. Në lidhje me paralajmërimin nga Brukseli se duhet të kihet kujdes në Sektorin për marrëdhënie me opinionin, kryeministri u përgjigj se Qeveria i respekton të gjitha rekomandimet. "I respektojme dhe do t'i respektojme të gjitha rekomandimet, absolutisht, njëqind për qind, natyrisht duke i elaboruar të gjitha argumentet tona, sepse diçka është e nevojshme, në dialog me Bashkimin Evropian", përmendi Zaev.

Prodhimet e Maqedonisë drejt tregun indian!

Shkup, 26 nëntor - Intensifikimi i bashkëpunimit ekonomik midis Maqedonisë dhe Indisë, ishte në fokus të takimit të kryetares së Lidhjes së Odave Ekonomike të Maqedonisë (LOE), Danella Arsovska dhe ambasadores së sapoemëruar të Indisë për Republikën e Maqedonisë

Pooxa Kapur. Siç kumtoi LOE-ja, në takim morën pjesë edhe kryetarët të odave të sektorëve në kuadër të Lidhjes, me ç'rast u nënshkrua Memorandum për bashkëpunim me Biznes asociacionin bal-kanik-indian (BABI) i cili vepron në drejtim të zgjerimit dhe zhvillimit

të bashkëpunimit ekonomik midis vendeve ballkanike dhe Indisë. "Përforsimi i lidhjeve ekonomike, thellimi i bashkëpunimit ekonomik dhe avancimi i këmbimit tregtar midis shteteve për shfrytëzimin e potencialit të tregut indian për kompanitë e Maqedonisë janë an-

gazhimet tona për periudhën e ardhshme", theksoi Arsovska dhe shtoi se Memorandumi për bashkëpunim pritet të sigurojë komunikim afarist, të nxitë iniciativa për pjesëmarrje të përbashkët të konferencave, simpoziume dhe këmbim aktual të të dhënave për përmirësimin e

marrëdhënieve afariste. Sipas LOE-së, India në vitet e fundit shënon rritje të konsiderueshme ekonomike. Këmbimi i përgjithshëm tregtar midis dy vendeve vjet ka arritur 58,4 milionë euro, nga të cilat eksport 17,4 milionë euro, ndërsa import 41 milionë euro.

Rritja e akcizës nuk duhet t'i shqetësojë bujqit

Shkup, 26 nëntor - Parlamenti të shtunën i votoi ndryshimet e Ligjit për akciza në pajtim me të cilat dizeli dhe nafta për ngrohje nga 1 janari i vitit 2018 do të shtrenjtohen për 3.5 denarë. Një vendim i tillë i Qeverisë, ende pa u miratuar zyrtarisht nga ana e Parlamentit, i bëri të ndarë bujqit. Disa mendonin se çdo pagesë shtesë është barë për prodhimtarinë dhe kërkojnë rishqyrtim të vendimit ose përjashtim të tij nga pjesa e agrarit, ndërsa disa të tjerë, se shtrenjtimi i naftës për 3.5 denarë nuk do të jetë shpenzim i madh. Gjatë debatit parlamentar, edhe deputetët e opozitës theksuan se rritja e akcizës, veçanërisht në bujqësi, është masë shumë e papëlqyeshme e cila do të sjellë deri në shtrenjtimin e ushqimit. Nga Ministria e Bujqësisë janë të drejtpërdrejtë, se rritja e akcizës nuk duhet t'i shqetësojë bujqit sepse me vendosjen e "naftës së gjelbër" shpenzimet për prodhimtarinë, dukshëm do të zvogëlohen. Sipas MBPEU, nuk duhet të shqetësohen as konsumatorët, sepse, siç informon, rritja e akcizës nuk do t'i shtrenjtojë prodhimet bujqësore të prodhuara në fermë. "Janë bërë të gjitha analizat e nevojshme për vendosjen e 'naftës së gjelbër' në bujqësi. Fillimi i masës është planifikuar për vitin 2018. Nafta e gjelbër do të thotë prodhimtari më të lirë dhe edhe një përfitim për të gjithë bujqit", tha ministri me portofol Lupço Nikollovski.

Shkupi, Kumanova dhe Manastiri më të ndotur

Shkup, 26 nëntor - Ajri më i ndotur sot në mëngjes, me koncentrim shumë të lartë të PM 2.5 grimcave, është në Komunën e Qendrës, treguan matjet për cilësi të ajrit që i publikoi Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor. Të ndotur me koncentrim të lartë të PM 2.5 janë edhe Karposhi, Manastiri dhe Kumanova, ndërsa për komunat e tjera nuk ka të dhëna. Vetëm në Tetovë matja tregon nivel shumë të ulët të PM 2.5. Koncentrimi ndërkaq, të PM10 është i lartë pothuajse në të gjitha komunat e Shkupit, Qendër, Karposh, Liçice dhe Gazi Babë, si dhe në Tetovë. Matjet tregojnë rritje çdo ditë të ndotjes së ajrit dhe tejkalim të vlerës mesatare ditore kufitare të PM10 e cila arrin 50 mikrogram në metër kub.

RRITEN FONDET PËR KULTURËN



NDRYSHOJNË PRIORITETET NË KULTURË

Filmi apo botimet e muzika nuk gjenden në top listën e veprimtarive të financuara më shumë, ashtu si vitet e tjera. Pa ndonjë reduktim të ndjeshëm të buxhetit janë Drama, Folklori, ndërsa zëra të tjerë si Trashëgimia, Manifestimet kulturore artistike, Muzetë, Talentet e reja, Eurointegrimet janë prioritet e reja ku do të shkojë pjesa më e madhe e buxhetit

Koha Evis HALILI

Shkup, 26 nëntor - Financimi i aktiviteteve kulturore do të jetë një prej sektorëve prioritarë edhe për vitin e ardhshëm. Trashëgimia, manifestimet, talentet e reja, eurointegrimet... janë disa prej zërave që do përfitojnë më shumë gjatë vitit të ardhshëm, duke lënë në hije botimet, apo filmin. Sipas projektbuxhetit të Qeverisë që pritet të miratohet, mjetet që planifikohet t'i akordohen Ministrisë së Kulturës dhe financimit të aktiviteteve nga sfera e kulturës është 113 milionë denarë më i madh sesa ai i vitit 2017. Por nëse për

vetë institucionin buxheti është reduktuar, financimi i aktiviteteve kulturore në të gjithë sektorët e kulturës është rritur ndjeshëm. Ashtu si edhe u paralajmërua nga drejtues të këtij institucioni, për ndryshime në prioritetet dhe politikat e zhvillimit të kulturës një gjë e tillë mund të shihet edhe në vetë shumatat që akordohen për zëra të veçantë. Filmi apo botimet dhe muzika nuk gjenden në top listën e veprimtarive të financuara më shumë, ashtu si vitet e tjera. Pa ndonjë reduktim të ndjeshëm të buxhetit janë Drama, Folklori, ndërsa zëra të tjerë si Trashëgimia, Manifestimet kulturore artistike, Muzetë, Talentet e reja, Eurointegrimet janë prioritet e reja ku do të shkojë pjesa më e madhe e buxhetit. Buxheti që planifikohet për këtë vit është relativisht i madh, sidomos po të krahasohet me atë të vitit 2017 që ishte mbi 600 milionë më i madh për shkak të përfundimit të një numri të madh projektsh kapitale, apo i cilësuar ndryshe si viti i inaugurimeve. Pjesa më e madhe e buxhetit për financimin e aktiviteteve i dedikohet Aktivitetit muziko-skenik me më shumë se 2 miliardë denarë dhe po ashtu një rritje të madhe të buxhetit do të

ketë edhe për manifestimet kulturore. Një zë i ri i shtuar këtë vit janë "Programet multidisiplinare", për të cilat do të vihet në dispozicion një fond prej 28 milionë denarësh. Veprimtaria muzeale po ashtu bën dallim, si një zë që do t'i jepet prioritet gjatë 2018-s. Bashkëpunimi ndërkombëtar si edhe Eurointegrimet janë dy zëra të tjera për të cilat Ministria e Kulturës do të vërë në dispozicion buxhet më të madh. E dyfishuar është edhe mbështetja për Talentet e reja, që parashikon një fond prej 4 milionë denarë. Procesi i decentralizimit dhe i transferimit të kompetencave do të vazhdojë. Buxheti i akorduar për vitin e ardhshëm është më i madh, afro 250 milionë denarë.

Për vitin e ardhshëm buxheti është rritur edhe për projektet që lidhen me financimin e kulturës shqiptare. Nëse deri në fund të vitit nuk do të ketë ndryshime dhe rebalanc të fondeve të parashikuara, mbështetja që do t'i jepet dy projekteve kapitale është dyfishuar, për përfundimin e Teatrit Shqiptar të Shkupit dhe vijimin e punimeve për ndërtimin e Teatrit dhe Bibliotekës në Tetovë vazhdojnë të figurojnë si projekte që duhet të realizohen edhe në



ANSAMBLI SHQIPTAR ME SELI NË SHKUP
"Mirëpres debatin shoqëror rreth nismës sonë së kamotshme për themelimin të Ansambllit shtetëror të këngëve dhe valleve shqipe në Maqedoni. Ky ansambël do të jetë përfaqësues i kulturës tonë autoktone, me të gjitha nishanet dhe ashtu si duhet dhe ashtu si presin profesionistët e lëmisë", shkruan deputeti i BDI-së, Artan Grubi në profilin e tij në Facebook, ndërsa ka informuar se ky Ansambël selinë do ta ketë në Shkup.

buxhetin e vitit të ardhshëm. Po ashtu si një investim tjetër më i madh është themelimi i një Ansambli shtetëror shqiptar të këngëve dhe valleve, sipas modelit "Tanec". Po ashtu edhe vënia në funksionim e Qendrës së Kulturës në Komunën e Likovës, projekt ky që zvarritet prej shumë vitesh. Ndonjë dallim të madh nuk ka për buxhetet e Shtëpisë së Alfabetit (pak i reduktuar), apo Qendrën e Konservimit në Gostivar. Po ashtu për projektin për Kalanë e Tetovës, i cili është mbyllur pa u përfunduar edhe këtë vit nuk gjendet në prezantimin e bërë nga Ministria e Kulturës.

PRIORITETET

Një zë i ri i shtuar këtë vit janë "Programet multidisiplinare", për të cilat do të vihet në dispozicion një fond prej 28 milionë denarësh. Veprimtaria muzeale po ashtu bën dallim, si një zë që do t'i jepet prioritet gjatë 2018-s

RIKTHEHET NDOTJA E
RREZIKSHME E AJRIT NË TETOVË

Fillimin e muajt e karakterizonte rritja e materive të dëmshme në ajër, pak më shumë se kufiri i lejuar që është 50 mikrogram në një metër kub. Ashti siç po kalojnë ditët e muajt, po ashtu rritet koncentrimi i materieve helmuese në ajër

GAZIFIKIMI DHE TRANSPORTI PUBLIK,
ZGJIDHJE PËR NDOTJEN

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 26 nëntor - Me afrimin e stinës së dimrit, po intensifikohet rritja e pranisë së grimcave të dëmshme PM10 në ajër. Përveç erës së pakëndshme të tymit, edhe të dhënat zyrtare nga stacioni matës i Ministrisë së Ambientit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor tregojnë për ajrin e ndotur, që gjithnjë e më shumë ditëve të fundit është prezent në qytetin e Tetovës.

Fillimin e muajt e karakterizonte rritja e materive të dëmshme në ajër, pak më shumë se kufiri i lejuar që është 50 mikrogram në një metër kub. Ashti siç po kalojnë ditët e muajt, po ashtu rritet koncentrimi i materieve helmuese në ajër. Në dy ditët e kaluara, më saktësisht të enjten, më 23 nëntor, kishte 187 grimca PM10. Në dy ditët e mëparshme nuk kishte të dhëna në Uebfaqen zyrtare të Ministrisë së Ambientit rreth asaj se sa kanë arritur materiet e dëmshme në ajër.

Në vitin që kaloi, tetovarët ishin dëshmitarë të asaj se janë zvogëluar shkaqet e ndotjes së ajrit, për faktin që fabrika Jugohrom nuk ka punuar si dhe me largimin e mbetjeve në deponinë e egër në hyrje të qytetit. Megjithatë, me ardhjen e muajve të ftohtë të stinës

së vjeshtës dhe dimrit, ajri i ndotur sërish është një shkak shqetësues te qytetarët.

"Ndotja në rajonin e Tetovës, por edhe në atë të Pollogut në përgjithësi dhe në gjithë Maqedoninë veçanërisht, në ato qytete ku kemi pasur vlera të larta të parametrave të ndryshëm që ndikojnë në ndotjen e ajrit, është akoma mjaft serioze. Me mbylljen e Jugohromit nuk është zgjidhur në tërësi ky problem, edhe pse kemi për 60 për qind ndotje më të ulët që nga koha kur kjo fabrikë punonte. Por, përsëri gjendja, veçanërisht tani në stinën e dimrit, është mjaft e përkeqësuar në Tetovë, sidomos në pjesët ku dihet që për nxehje dhe për nevojat e amvisërisë si lëndë djegëse përdoret druri ose nafta. Gjatë kësaj periudhë kohore, edhe komunikacioni është i stërngarkuar dhe kjo ndikon akoma në shtimin e ndotjes. Edhe pse matësi i Ministrisë së Ambientit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor nuk tregon vlera mjaft të larta, matësit tanë të instaluar në disa lokacione të qytetit, tregojnë vlera shumë të larta që arrijnë deri në 400 grimca PM10 në një metër kub ajër", deklaroi Narta Kasa, nga Shoqata "Nëna dhe Fëmija".

Arianit Xhaferi, nga Lëvizja Eco



NARTA KASA

Me mbylljen e Jugohromit nuk është zgjidhur në tërësi ky problem, edhe pse kemi për 60 për qind ndotje më të ulët që nga koha kur kjo fabrikë punonte. Por, përsëri gjendja, veçanërisht tani në stinën e dimrit, është mjaft e përkeqësuar në Tetovë, sidomos në pjesët ku dihet që për nxehje dhe për nevojat e amvisërisë si lëndë djegëse përdoret druri ose nafta.

Guerilla, thotë se duhet që përfundimisht të realizohet gazifikimi në përgjithësi për Pollogun dhe të subvencionohen familjet që janë të sfiduara ekonomikisht.

"Duhet që Qeveria të mendojë për zgjidhje afatgjate, sepse pjesa më e madhe e qytetarëve të Tetovës ngrohen me dru, por edhe me lëndë të tjera djegëse, që në masë të madhe e ndotin ajrin. Së këndej-

mi, inspektorati duhet të jetë më aktiv, ndërsa si zgjidhje e tërë kësaj ndotje, duhet që përfundimisht të aktivizohet transporti publik në Tetovë, ndërtimi i deponisë rajonale si dhe gazifikimi i rajonit të Pollogut, që do të ishte një zgjidhje më e mirë për të ulur ndotjen", tha Arianit Xhaferi nga Eco Guerilla.

Një ndër shkaqet e ndotjes së ajrit është sezoni i ngrohjes, gjegjësisht ngrohja me djegie të druve të hapësirave të banimit dhe hapësirave të bizneseve, por edhe ajo që qytetarët shfrytëzojnë lëndë të ndryshme të cilat i djegin në furra.

Në rrjetet sociale ditëve të fundit qytetarët publikojnë fotografi përmes të cilave tregojnë tymin e dendur që del nga oxhaqet, duke besuar se ky tym është si pasojë e shfrytëzimit të lëndëve të papërshtatshme djegëse për ngrohjen e hapësirave të banimit dhe lokaleve.

Brenda një viti, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, në botë vdesin rreth 3.7 milionë njerëz nga ajri i ndotur. Nga ky fenomen është prekur popullsia e shëndetshme, por më shumë që janë prekur nga ajri i ndotur janë të sëmurët kronik, ata të cilët kanë sëmundje të zemrës, persona me shtypje të lartë të gjakut, shtatzënat, të sapolindurit si dhe diabetikët.

Mirënjohje
për
dëshmorët
e luftës së
Kosovës

Tetovë, 26 nëntor-Shoqata e Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka dekoruar me mirënjohje dëshmorët nga Maqedonia, të cilët kanë rënë në luftën e Kosovës. Mirënjohjet janë ndarë pikërisht në 20 vjetorin e daljes publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në vitin 1997. Po ashtu, mirënjohje u ndanë edhe për ata që kontribuan në luftën e vitit 1998/99. Hysni Guxati, kryetar i Shoqatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, tha se kjo është një mirënjohje për të gjithë ata që kanë dhënë kontribut në çlirimin e Kosovës. Sipas tij, dëshmorët dhe ata që luftuan nuk do të harrohen asnjëherë. Në ndërkohë, Hazbi Lika, tha se kjo është një mirënjohje për sakrificën e mbarë popullit shqiptar që ndihmuan në shumë mënyra luftën e Kosovës. Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, tha se nuk do të mund t'u dilet hakut asnjëherë dëshmorëve, sepse ata kanë dhënë jetën për çlirimin e Kosovës. Ahmeti nënvizoi se sado që të jepen mirënjohje dhe dekorata, asnjëherë nuk do të mund kompensohet sakrificat e dëshmorëve të kombit. Në mesin e atyre që morën mirënjohje, ishin Ali Ahmeti, Hazbi Lika, Ismet Jashari, Beqir Limani, Mujdin Aliu, Zeqirja Dardhishta, Remzi Xhaferi, Shabi Kajolli, Aliriza Selmani, Ismet Mustafa, Safet Ajeti, Isa Lika, Nuri Mazari, Naser Ademi, Imri Elezi, Rahim Samiu, Ismail Mehmeti – Komandant Fisheku, Nuri Bexheti, Bilall Ceka, Muhamer Vejseli dhe kreu i BFI-së, Reis Sulejman efendi Rexhepi. (u.h.)

Liqeni i Ohrit fsheh shtatë anije të mbytura

Shkup, 26 nëntor - Shtatë anije në Luftën e Parë Botërore janë zhytur në Liqenin e Ohrit. Mbetjet e tyre janë ende të fshehura në fund të liqenit të Ohrit pranë Strugës. Anijet e fundosura në liqenin e Ohrit eksplorohen dhe dokumentohen nga Qendra për zhytje "Akuatek". Daniel Atanasovski nga "Akuatek" për MIA-n deklaroi se numri i anijeve nuk është përcaktuar saktë dhe ende nuk është

dokumentuar mjaftueshëm. "Shumë informata janë të njohura për këto anije si prodhuesit e tyre dhe se ato janë përdorur për transportimin e një ngarkese të madhe", thotë Atanasovski, duke shtuar se ka hapësirë dhe motiv për kërkime të mëtejshme. Anijet ndodhen 1.000 metra larg bregut pranë qytetit të Strugës në një thellësi prej gjashtë deri në shtatë metra. Numri përfundimtar

i këtyre anijeve duhet të konfirmohet, por besohet se janë shtatë, domethënë dy anije kryesore të cilat kanë tërhequr pas tyre anije ndihmëse që mbanin ngarkesën. Mbi to janë parë markat e prodhuesve të tyre, të anijeve "Bolzano, Tedesko & Co", thotë Atanasovski. Nuk ka informata të sakta për atë që i zbuloi për herë të parë, por që atëherë ata nuk janë hulumtuar në detaje.

Ekipi i "Akuatek", sipas Atanasovski, së bashku me arkeologun nënujor Nikola Paskali, do të vazhdojë të hulumtojë, dokumentojë dhe promovojë këtë lokalitet. Nga aktivitetet e tyre, ata kanë krijuar një video për anijet që është publikuar në kanalim. Sipas Atanasovskit, motivimi për eksplorimin dhe dokumentimin e anijeve në liqenin e Ohrit është krijimi i një arkivi cilësor fotografik dhe

video që do të përdoren më tej për qëllime kërkimore, si dhe për promovimin e lokalitetit. Ka shumë struktura lundruese në Liqenin e Ohrit që janë të vjetra, të shkatërruara dhe të ankoruara, dhe së fundmi nisën aktivitete për tërheqjen e Mis Stone nga kanali i Studençishkit për shkak të derdhjes së karburantit. Anija u ankorua në këtë kanal dhe ishte pjesërisht nën ujë. (mia)

Shansi i Francës dhe i Macronit

Vetëm tre muaj më parë, kryeministrja polake fliste për "arrogancë dhe mungesë përvoja", pasi Emmanuel Macron kishte deklaruar se Polonia nuk meriton të ketë liderë, që vënë në dyshim sundimin e ligjit, shtyjnë vendin e tyre "në skajet e historisë së tashme dhe të ardhme të Evropës".

Në atë kohë ishte e arsyeshme për t'u shqetësuar në pritje të takimit të planifikuar të 23 nëntorit në Elysee, por në fakt Kryeministrja Beate Szydło doli e qeshur nga takimi, duke deklaruar se "nuk ka pastrim mosmarrëveshje të mëdha mes Francës dhe Polonisë", dhe duke theksuar se është tërësisht e natyrshme që të "ekzistojnë disa divergjenca".



Nga Bernard GUETTA

Franca gjendet sot në një situatë, të cilën nuk e përjetonte prej viteve të shkëlqimit të saj. Sigurisht, ekonomia franceze nuk e ka kaluar atë gjermane




Në çdo rast, nga kjo ngjarje dalin tre vlerësime. E para është se ekziston një metodë Macron, efektive si me Jean-Luc Mélenchon, ashtu edhe me nacionalistët polakë. Kjo metodë konsiston në deklarimin publikisht dhe në mënyrë të qartë, se cilat janë problemet, për të kaluar më pas, në një manovër ribashkimi bazuar në interesa të përbashkëta. Kjo është një metodë me sa duket e pagabueshme, sepse nuk lë vend për të pathëna, sepse rezervon gjithmonë surpriza të kënaqshme, dhe për shkak se ka gjithmonë interesa të përbashkëta që mund të bashkohen. Mësimi i dytë që duhet nxjerrë nga takimi i 23 nëntorit është se vendet si Polonia dhe Hungaria kanë shumë për të humbur nëse dalin nga BE. Nacionalistët e pozicionuar në të djathtën ekstreme, ata që qeverisin të dy vendet sulmojnë institucionet dhe kryeqytetet evropiane, por ekonomitë e tyre kanë shumë nevojë për fonde dhe për tregun e përbashkët, që të guxojnë të vënë vërtetë në provë durimin e liderëve të tyre. Vlerësimi i tretë është se Franca gjendet sot në një situatë, të cilën nuk e përjetonte prej viteve të shkëlqimit të saj. Sigurisht, ekonomia franceze nuk e ka kaluar atë gjermane dhe Macron nuk ka hedhur bazat e një federalizimi të Lindjes së Mesme. Pavarësisht vullnetit të mirë të presidentit, nuk kemi mbërritur ende në këtë pikë. Megjithatë, paparashikueshmëria e Donald Trump ka hequr mënjanë SHBA, ndërkohë që Brexit dobëson edhe më shumë ekonominë e Mbretërisë së Bashkuar (një nga tre fuqitë evropiane) dhe Gjermania kalon një krizë politike tipike si ato që zakonisht i kalojnë vendet e Mesdheut. Kështu që, mbetet Franca, ku presidenti po e shfrytëzon këtë moment popullariteti të madh, për t'u afirmuar në të gjithë frontet. (France Inter)

NË SHIRTIN E KOHËS

Epri është dhe do mbetet shqiptar

Nga Abdyl FRASHËRI



Zotëri Redaktor! Me habipamë se gazeta e rëndësishme "Republique Française", e cila në polemikën e saj të zakonshme kurrë nuk devijon nga rregullat e modestisë, botoi disa pjesë të shkëputura nga Memorandumi i Lidhjes Shqiptare, dhe poshtëroi e bëri qesharake atdhetarët tanë. Atij artikulli nuk i dhamë asnjë përgjigje, por "Republique Française", duke u rikthyer prapë në çështjen në fjalë, u orvat të tallë dy të dërguarit e Lidhjes Shqiptare. Një sjellje të tillë fare nuk e pritnim prej një gazetave që simpatizonte luftën e kombësive. Franca qanë gjithmonë humbjen e krahinave të saj: banorët e Alsace e Lorraine rënkojnë kur kujtojnë privimin e kombësisë së tyre. Përse një gazetë franceze i gjen qesharake shqiptarët, të cilët përpiqen të evitojnë rrezikun e një fatkeqsisë të tillë? Nuk jemi savantë dhe as pretendojmë për të, por historinë e atdheut tonë e kemi studjuar dhe e dimë më mirë se kushdo tjetër.

Banorët e Epirit i quajnë "Pel-lazgë". Herodoti, Tucididi dhe Straboni dalin me konkluzionin se ky vend nuk ka qenë pjesë e Greqisë. Sipas Strabonit, Greqia nga veriu kufizohet prej Akarnanisë dhe Cjiut

të Ambrakisë. Pasi gjeografia e lashtë greke nuk u vjen në ndihme grekëve të sotëm, po pyesim ata që kanë mendime të kundërta, se cila pjesë e Epirit është greke? Ai që pranon argumentet e sillogëve grekë do të besojë se Greqisë nuk i përket vetëm Shqipëria, por edhe Maqedonia, Thraka, Rumania, Azia e Vogël, sipas vendeve të Greqisë së Madhe, edhe Marseja e juaj!!! Epiri ka 650 mijë banorë.

Sa janë vallë grekët që ndodhen në të dhe ku banojnë? Në Korçë? Në Berat? Në Gjirokastrë? Apo në Çamëri? Ai që kalon nëpër këto vende takon vetëm epirotë shqiptarë, jo epirotë grekë. Do të sakrifikohe-shin pra 650 mijë shqiptarë puro për të nginjur lakmitë e sillogëve grekë dhe lëvizjet artificiale të tyre...

Sjellja e tanishme e Greqisë dëshmon se ajo ka ndërmend të imitojë Rusinë Cariste!!! Por kjo (Rusia) i përkrahë pretendimet e saj me anën e forcës, e cila për fat të mirë i mungon Greqisë. Sikur të ishin grekët aq të fortë sa tregohen!!! Që në fakt janë vetëm miq të zhurmës, Europa nuk do të kish-te kurrë qetësi. Parimi i ngjashmërisë në gjuhë do të shpiente Greqinë shumë larg, por në rradhë të parë do të na jepej neve e drejta të

Europa do të marrë përsipër përgjegjësinë e luftërave shkatërrimtare që do të inauguronte për aneksimin e shëmtuar të tokave tona nga Greqia



kërkojmë nga grekët dyqind mijë shqiptarët që banojnë në një lagje të veçuar të Athinës të quajtur "Plakë", dhe krejt ishujt Hidra dhe Spëca.

Epiri është dhe do të mbetet gjithëmonë shqiptar, ashtu si e krijoi natyra dhe historia. Mëkat që qeveria greke shpenzon për sillogjet shuma të majme, të cilat mund t'i përdorte në mënyrë më të arsyeshme. Ajo përpiqet t'i zgjasi një ngatërrese, e cila s'ka për të mashtruar asnjë evropian. Po të ngulë këmbë Greqia në aspiratat e lakmitë e saj të pangopura, të cilat i kundërvihen drejtësisë dhe të drejtës së kombeve, shqiptarët kanë një vullnet të patundur që të mbrojnë atdheun e tyre deri në fund dhe janë betuar të mos lëshojnë asnjë pëllëmbë tokë por të vdesin për të po të jetë nevoja. Këtu manifestojmë mendimin e të gjithë bashkë-atdhetarëve tanë.

Europa do të marrë përsipër përgjegjësinë e luftërave shkatërrimtare që do të inauguronte për aneksimin e shëmtuar të tokave tona nga Greqia. Shpresojmë, zoti redaktor, se do ta botoni përgjigjen tonë, gjë për të cilën dhe ju falënderojmë qysh më parë. (Botuar më 1879)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premtë 24 nëntor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndhimskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktorë: Shkëlzen HALIMI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Tifozi bëhet gjyqtar!

Ka ndodhur diçka mjaft e rrallë në futboll, posaçërisht atë evropian. Në ndeshjen mes Norviç Sinit dhe Prestonit, që loja të vazhdojë në mënyrë të rregull, u nevojiti që një tifoz të jetë gjyqtar i katërt i takimit. Tifozi i njohur i Norviçit, David Thornhill, për 15 minuta nuk ishte një tifoz i thjeshtë, ai la ulëset e "Carrow Road" për të marrë një detyrë të rëndësishme në këtë takim.



LIGA E PARË, MBYLLET JAVË E 16-TË

SHKËNDIJA DHURON SPEKTAKËL NË FUSHË, "BALLISTËT" NË TRIBUNA



Në një atmosferë imponante e krijuar nga grupi i tifozëve "Ballistët" të cilët njëherit festuan edhe 25 vjetorin e themelimit, skuadra e Shkëndijës ka mundur me rezultatin e thellë 6-1 Renovën, në kuadër të derbit shqiptar. Fitore kjo e cila edhe më shumë i ofron kuqezinjtë drejt titullit të dytë në historinë e tyre

Alioski arrin në kuotën e pesë golave

Shkup, 26 nëntor - Ezgjan Alioski ka vazhduar serinë e golave në Angli. Në ndeshjen që skuadra e tij Lids Junajted e zhvilloi kundër Barnslit, futbollisti shqiptar shënoi në minutën e 45 për 0-2, por edhe asistoi për 0-1 në minutën e 21. Në fund skuadra e tij arriti fitore me 0-2. Për reprezentuesin e përfaqësueses së Maqedonisë ky ishte goli i pestë në fanellën e Lids në "Championchip" duke dëshmuar formën e shkëlqyer nëpër të cilën po kalon.

Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 26 nëntor - Skuadra e Shkëndijës ka Tetovës ka dhuruar spektaklin e radhës në kampionatin vendor, duke fituar në derbi 6-1, që ishte si udhëtues ndaj Renovës. Por më shumë se sa spektakli në fushë, ishte tifo-grupi "Ballistët" ata që kanë "djegur" stadiumin me koreografinë dhe tymueset me rastin e krenimit të 25 vjetorit të themelimit të tyre. Sa i përket ndeshjes, Shkëndija e ka zgjidhur ndeshjen që në pjesën e parë, duke shënuar plot 3 gola. Fillimisht Ibrahim shënon që në minutën e tretë, pastaj Hasani dyfishon në 27 dhe më pas Ibrahim mbyll pjesën e parë. Me fillimin e pjesës së dytë, Renova shënon golin e nderit me Mishkovski. Por ky gol ka karikuar ku-

REZULTATET:

RENOVA - SHKËNDIJA	1-6
A.PANDEV - VARDARI	0-2
SILEKSI - RABOTNIÇKI	2-1
"SKOPJE" - POBEDA	0-1
PELISTERI - SHKUPI	2-2



Ferhan Hasani


"Fitorja dhe titulli i kampionit vjeshtor janë një lloj dhurate për tifozët tanë 'Ballistët' dhe ditëlindjes së tyre. Sot ishim të shkëlqyer, por nuk duhet të lejojmë të lirohemi, dhe me fitore ndaj Pelisterit ta rumbullaksojmë sezonin vjeshtor në të cilin po luajmë futbollin më të mirë në Ligë", deklaroi pas përfundimit të ndeshjes Ferhan Hasani.

qezinjtë që shënojnë 3 gola radhazi, me Zhunior, Shefiti dhe Hasani sërish. "Fitorja dhe titulli i kampionit vjeshtor janë një lloj dhurate për tifozët tanë 'Ballistët' dhe ditëlindjes së tyre. Sot ishim të shkëlqyer, por nuk duhet të lejojmë të lirohemi, dhe me fitore ndaj Pelisterit ta rumbullaksojmë se-

zonin vjeshtor në të cilin po luajmë futbollin më të mirë në Ligë", deklaroi pas përfundimit të ndeshjes Ferhan Hasani.

Ndërkohë, në ndeshjet tjera, Shkupi përkundër negatives prej 2-0 në pjesën e parë në përballjen me Pelisterin, arriti që në pjesën e dytë të

shënojë dy gola dhe të fitojë një pikë të madhe në Manastir. Vardari në cilësinë e mysafirit mundi "Akademija Pandev", kurse Sileksi me përmbysje arriti të mund Rabotniçkin me 2-1, derisa tre pikë mjaftë të rëndësishme i ka arritur Pobeda, e cila si mysafir mundi "Skopjen" me 0-1.



Shkup, 26 nëntor - Imer Kadriu është kryetari i ri i Klubit të Mundjes "Liria". Kështu vendosën dje anëtarët e klubit më të suksesshëm shqiptar në Kuvendit e jashtëzakonshëm, që u mbajt në hapësirat e klubit. Cekim, me shumë sukses nga viti 2010 e deri

më 2017 KM "Liria" e udhëhoqi Betim Vrenezi, i cili nga ky post u largua pasi u emërua për kryetar i Federatës së Mundjes së Maqedonisë. Sipas Vrenezit, Imer Kadriu ka qenë njeriu u duhur për këtë post duke marrë parasysh kontributin që e ka dhënë për këtë

KADRIU, KRYETARI I RI I KM "LIRIA"

klub. "Imer Kadriu ka qenë mundës dhe njëri prej sponsorëve më të mëdhenj nga viti 1990. Ai gjithmonë dhe në çdo moment dhe në të mirë e në të keqe, ka përkrahur klubin. E di që ai nuk ka dëshirë ti përmendi gjitha këto, por e kam patjetër. Andaj uroj që ai të vazhdojë me sukses udhëheqjen te KM "Liria", tha ish-kryetari i klubit "Liria", Betim Vrenezi.

"Falënderoj të gjithë për besimin që ma dhatë. Në fakt unë jam pjell e këtij klubi, këtu jam rritur dhe jam zhvilluar dhe do të jem këtu gjithmonë. Edhe pse kam qenë larg, me zemër kam qenë me ju. Me ardhjen e Betim Vrenezit në krye të klubit, u bë një revolucion.

ALILI, MË I MIRI NË TURNIRIN MEMORIAL "MENTAZ ALLAJBEGU"

Dje në hapësirat e KM "Liria" u mbajt edicioni i katërt i turnirit memorial për fëmijë (2008/09) "Mentaz Allajbegu". Në këtë turnir mjaftë të rëndësishëm morën pjesë mbi 80 mundës nga klubet e Maqedonisë, Kosovës dhe



Shqipërisë. Derisa, mundësi më i mirë i këtij turniri memorial u shpall mundësi i KM "Liria" Besir Alili. Në anën tjetër, Rexhep Pocesta u shpall mundësi më i mirë vendor, ndërsa Egzon Xhoni, mundësi më i mirë i huaj.

Kemi qenë unik dhe të bashkuar, për gjithçka që kemi bërë. Unë pa përkrahjen e juve nuk mund të bëj asgjë, prandaj nëse qëndrojmë të bashkuar, s'ka dyshim se do ta

qojmë klubin drejt një profesionalizimi edhe më të madh që Klubit "Liria" t'ia kthejmë namin e dikurshëm", deklaroi tani më kryetari i ri i KM "Liria", Imer Kadriu.

HAMZAJASHARI, XHUDIST I KXH 'MIOKI'

KOSOVA KA MAJLINDËN, MAQEDONIA HAMZA JASHARIN

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 26 nëntor—Hamza Jashari para dhjetë ditësh hyri në histori, duke u bërë xhudisti i par i cili ia ka sjell Maqedonisë medaljen e parë të arit pas nëntë viteve ekzistencë në Kupën Evropiane, e cila u mbajt në Gyor të Hungarisë. Jo vetëm për xhudon e Maqedonisë, por edhe për Hamzan kjo ishte medalja e parë e arit prej vitit 2012 kur zyrtarisht filloi të merr pjesë në gara. Për gazetën KOHA, Hamza edhe një herë rrëfen rrugëtimin e tij deri te ky sukses i madh si dhe tregon për hapat e parë në sportin e xhudos, sukseset e tij të deritanishme dhe synimet e tija në vitin 2018.

“Rruga deri te ky sukses aspak nuk ka qenë e lehtë. Gjithsejtë kisha pesë lufta, ndërsa më rëndë e pata në xhiron e tretë kundër hungarezit të cilin e munda me 1 vazar. Një sukses i cili hyri në historinë e xhudos së Maqedonisë, ndërsa për mua është edhe me vlerë duke marr parasysh se këtë sukses Maqedonia ia solli një shqiptar. Më duhet të pranoj se një sukses të tillë e kam pritur, pasi një gjë të tillë isha afër ta bëj në Slloveni në Kupën Evropiane, kur humba në luftën për medaljen e bronzit. Jam i kënaqur shumë me këtë sukses, por më së tepërmi për familjen time, pasi ata më kanë përkrahur më së shumti drejt këtij suksesi”, shprehet në fillim 16-vjeçari nga Nerezi i Shkupit. Ndryshe kur jemi te ky sukses, vlen të përmendim se i njëjti nuk u la pa u përmend edhe nga faqja zyrtare e Xhudos Evropiane, ku Maqedonia u gjend për herë të parë.

HAPAVE TË BABAIT

Ndryshe, Hamza me xhudo ka filluar të merret prej moshës 9-10 vjeçare te klubi “Ipon” nën udhëheqjen e trajnerit Mustafa Fetahu. “Me xhudo kam filluar të merrem prej moshës 9-10 vjeçare te klubi ‘Ipon’ nën udhëheqjen e trajnerit Mustafa Fetahu. Arsyet se pse jam marr me xhudo ka qenë babai, i cili gjithashtu në të kaluarën është marr me këtë sport derisa për trajner ka pasur gjithashtu Mustafa Fetahun. Ishte dëshira e babait që unë të ndjek hapat e tij, dhe kuptohet unë këtë dëshira ia plotësova”, shtoi më tej Jashari.

KAMPIONATI SHTETËROR, GARA E PARË ZYRTARE

Me fillimet e para me sportin e xhudos, Hamza filloi të merr pjesë edhe në disa turnirë në Maqedoni,

Jo vetëm për xhudon e Maqedonisë, por medalja e arit në Gyor të Hungarisë ishte medalja e parë e arit prej vitit 2012 kur zyrtarisht filloi të merr pjesë në gara. Për gazetën KOHA, Hamza edhe një herë rrëfen rrugëtimin e tij deri te ky sukses i madh si dhe tregon për hapat e parë në sportin e xhudos, sukseset e tij të deritanishme dhe synimet e tija në vitin 2018



Arsyet se pse jam marr me xhudo ka qenë babai, i cili gjithashtu në të kaluarën është marr me këtë sport derisa për trajner ka pasur gjithashtu Mustafa Fetahun. Ishte dëshira e babait që unë të ndjek hapat e tij, dhe kuptohet unë këtë dëshira ia plotësova



”



“Klubi ‘Mioki’ nuk ka kushte që të mi mbulojë harxhimet për pjesëmarrje në gara, kështu që kam qenë i detyruar që harxhimet ku kam marr pjesë në gara ti mbuloj vetë. Turnirët nuk janë të shtrenjta, por Kupat kushtojnë. Shembull një pjesëmarrje atje kushton 500 euro. Nuk mund të mos e përmend përkrahjen e madhe që e kam pasur nga ish-kryetari i Komunës së Çairit Izet Mexhiti. Ai është njeriu i cili më ka ndihmuar më së shumti deri më tani dhe për këtë e falënderoj shumë”.



ndërsa në një garë zyrtare ka marr pjesë në Kampionatin shtetëror në vitin 2012 ku edhe është shpallur kampion i Maqedonisë. “Në vitin 2012 për herë të parë kam marr pjesë në një garë zyrtare kur u shpalla kampion shtetëror për pionier të rinj. Që prej atëherë e deri më 2017 unë jam kampion i pakontestueshëm i Maqedonisë. Sa u përket turnirëve jashtë Maqedonisë, kam marr pjesë në Serbi, Bullgari, Kosovë, Shqipëri, Slloveni, Gjermani. Derisa, do të kisha dalluar Kampionatin Ballkanik në Serbi, kur e zura vendin e tretë dhe në Slloveni (2017) kur humba në luftën për medaljen e bronzit. Gjithashtu do të kisha veçuar edhe Kampionatin Evropian në Lituani në vitin 2017, ku humba në luftën për medaljen e bronzit nga garuesi rus”, vazhdon rrëfimin e tij shpresa e xhudos së Maqedonisë.

MUNDËS I KM “LIRIA” NË VITIN 2016

Është interesante të përmendet se Hamza në vitin 2016 ka qenë mundës i KM “Liria” nga Shkupi. “Për shkak se përgatitjet fizike në klub ishin të dobëta, u detyrova të merrem me mundje edhe atë te klubi më i suksesshëm shqiptar ‘Liria’. Aty qëndrova një vit dhe gjatë kësaj periudhe kam marr pjesë edhe në gara të ndryshme, si kampionatin shtetëror për pionier (vendi i tretë) dhe disa turnirë tjera. Realisht qëllimi im ishte që të stërvitem në aspektin fizik se sa të marr pjesë në gara. Megjithatë u jam falënderues kryesisht së klubit, trajnerëve dhe mundësve për hapësirën që ma dhanë për tu stërvitur. Ata asnjëherë nuk më kanë ndarë nga mundësit tjerë edhe pse e dinin se sporti i xhudos për mua ishte në rend të parë. Përsëris u jam falënderues për këtë, ndërsa edhe ata janë pjesë e suksesit që e arrita në Gyor të Hungarisë. Me ndihmë të Federatës, unë dhe xhudistët tjerë stërvitemi me mjeshtrin e xhudos nga Rumania, Gabriel Saptu, i cili është edhe trajner i përfaqësueses së Maqedonisë”, tregon xhudisti shqiptar, i cili ka 3 vite që është pjesë e skuadrës së “Mioki” nga Shkupi.

NDIHMË NGA ASKUSH, PËR GARA PAGUAN NGA 500 EURO

Ndryshe, Hamza bën të ditur se në përjashtim të pjesëmarrjes në Kupën Evropiane në Gyor të Hungarisë, deri më tani në gara ka marr pjesë me vetëfinancim. “Klubi ‘Mioki’ nuk ka kushte që të mi mbulojë harxhimet për pjesëmarrje në gara, kështu që kam qenë i detyruar që harxhimet ku kam marr pjesë në gara ti mbuloj vetë. Turnirët nuk janë të shtrenjta, por Kupat kushtojnë. Shembull një pjesëmarrje atje kushton 500 euro. Nuk mund të mos e përmend përkrahjen e madhe që e kam pasur nga ish-kryetari i Komunës së Çairit Izet Mexhiti. Ai është njeriu i cili më ka ndihmuar më së shumti deri më tani dhe për këtë e falënderoj shumë”, bën të ditur Jashari. Në fund 16-vjeçari Hamza Jashari pret që pas këtij suksesi të ndryshojnë gjërat, ndërsa ka marr premtime se do të ndihmohet nga Komiteti Olimpik i Maqedonisë dhe është në pritje të realizimit të premtimeve që ka marr nga ata. Derisa, në vitin 2018 ai pret që të merr pjesë në Kampionatet Botërore dhe Evropiane ky synon të arrij sukses.

ISHTE SHUMË I VARFËR, SOT ËSHTË LOJTARI MË I SHTRENJTË NË BOTË

“Ne nuk filluam nga zero ... filluam nga minus pesë”. Kështu fillon tregimi i Nejmar Sr, babait të Nejmar, i cili tregon kontrastin e thellë të jetës së djalit të tij, që dikur ishte shumë i varfër ndërsa sot është lojtari më i shtrenjtë në botë



Sulmuesi brazilian është transferuar për 222 milionë euro gjatë verës së kaluar nga Barcelona tek Paris Saint-Germain, duke e bërë klubin francez të jetë sërish në qendër të vëmendjes së mediave botërore. Rihanna, Tyga, Naomi Campbell, Kardashianët dhe Bekamët janë vetëm disa prej yjeve botërore që kanë qëndruar në shkallët e stadiumit të skuadrës franceze pas transferimit të Nejmarit. Xhastin Biber, Drake dhe Luis Hamilton janë vetëm tre prej shumë yjeve botërore që janë miq të futbollistit. Por, artikujt e mediave rreth ndejave të shfrenuara dhe jetës sikur të një ylli holivudian, kanë bërë që shikuesit të pyesin nëse Nejmar po i largon sytë nga topi. Por, shumë shpesh, talenti shkon i paplotësuar pasi gjithnjë e më shumë zero shfaqen në fund të bilancit bankar.

Duke u rritur në Mogi das Cruzes, në periferi të Sao Paulos, jeta e kaluar e kapitenit të Brazilit ishte “mizorie” në fillim. Kohët ishin aq të vështira për prindërit e futbollistit, nënës Nadine dhe babait, Nejmar Sr, sa ata nuk mundën të përballonin shpenzimet as edhe të një skanimi me ultratinguj para lindjes së futbollistit. Dhe, në moshën katër muajshe, Nejmar i mitur mbijetoi mrekullisht duke u hedhur nga një automobil gjatë një përplasje të tmerrshme që e la babanë me një brinjë të thyer. Si një foshnjë, Nejmar kishte jetuar në një shtëpi të vogël me qira dhe pa energji elektrike. Prindërit e Nejmar festuan ditëlindjen e parë, ku nëna e përshkruante zonën si “një lagje shumë e ulët sociale”, duke shtuar “Ne jetuam aty kur ishte një fushë për hedhjen e mbeturinave të qytetit”. E gjithë familja – tani me shtimin e foshnjës Rafaella – nuk kishte mundësi përveçse të shkonte në shtëpinë e vogël të gjyshërve të Nejmarit, ku gjithçka që kishin ishte një dyshek. Dhe, ndërsa Nejmar i ri zhvilloi aftësitë me top në rrugë, babai

i tij punoi tre punë – si një punëtor krahu, një mekanik dhe shitës – vetëm për të pasur një çati mbi kokat e të gjithëve. “Kjo nuk ishte shumë kohë më parë, rreth vitit 2000. Ne jetuam atje derisa Nejmar u bë një profesionist”, tha Nejmar Sr, duke folur rreth jetës së djalit të tij. “Ne gjithmonë e kemi ndihmuar të ndjekë ëndrrat, që nga mosha shumë e hershme. Si fëmijë, ai donte të ishte gjithçka – ‘Superman’, ‘Power Rangers’. Ai ishte hiperaktiv dhe ende është”, shtoi Nejmar Sr. Dhe përkushtimi i babait të tij është diçka që Nejmar nuk e ka harruar, pavarësisht rritjes së popullaritetit botëror.

Marrëdhënia e tyre ka qenë e rëndësishme për çdo hap në karrierë. Nuk është rastësi që Nejmar mban emrin e babës në fanellë. Dhe kjo nuk ishte kurrë më e dukshme se sa në një mesazh në “Instagram” para nënshkrimit me PZHG-në, kur Nejmar shkroi “Ju përfaqësoj të gjithë miqtë e mi. Ti je një nga gjërat më të mira që kam në jetë. Të dua babi!” Afërsia e patundur e Nejmarit me familjen nuk ndalet atje. Ai ka të vizatuar në trup fytyrat e së motrës së tij, Raffaellas, nënës Nadine dhe djalit, Davi Luka.

Nejmar debutoi si futbollist profesionist te Santos në moshën 17-vjeçare, pasi nuk e transferoi në moshën 14-vjeçare Real Madridi. Pas zhgënjimit me Los Blancos, babai nënshkroi një marrëveshje me palën braziliane para se të negociojnë çdo transferim të ardhshëm. Dhe, kur përfundimisht bëri kalimin në Evropë te Barcelona në vitin 2013, jeta e gjithë familjes ndryshoi përgjithmonë. Duke vepruar si agjenti i djalit të tij, Nejmar Sr fitoi 35 milionë funte duke ndërmjetësuar transferimin – një paradhënie prej 9 milionë funteve para se të merr edhe 26 milionë funte pas finalizimit të marrëveshjes. Thëksojmë se Santos mori vetëm 15 milionë funte për ta zhvilluar dhe edukuar si futbollist.

Publicitet

libri i artë
2017 / 18

udhërrëfyes mjekësi
FAQ. 133

udhërrëfyes mobilje/ndërtimtari
FAQ. 153

KOPJE FALAS
me gazetën Koha
më 2 Dhjetor
(e shtunë)

ZBRITJE DHE GRATISE
24 KUPONË PREMIUM

www.zk.mk

iPhone app
Android app

MACEDONI



EMAILAT QË ZBULOJNË ANËN E ERRËT TË BEKAM



Reputacioni i Dejvid Bekam është në rrezik pas një sërë email-esh që janë zbuluar nga mediat evropiane, sipas "The Sun". Emailat, për të cilat "The Sun" thotë se janë zbuluar nga një grup gazetarësh investigativë evropianë, tregojnë zemërimin e tij pasi Mbretëresha akoma nuk po i jep titullin "Sir" si dhe përplasje të shumta për sa i përket përgjegjësisë të tij të UNICEF. Bekam akoma nuk është prononcuar mbi këtë çështje, por

zëdhënësi i tij Simon Oliveira thotë se emailat janë të vjedhura dhe të hakuara. Emailat kanë zbuluar se ai ka kryer një fushatë mediatike për titullin më të lartë anglez, ku përfshihej një paraqitje në spektaklin televiziv "The Jonathan Ross Show", por fushata ishte një dështim. Pasi Mbretëresha publikoi listën që do të nderohej në dhjetor të 2013, Bekam e quajti listën "një turp", duke shtuar se "njerëzit e zgjedhur ishin një tufë horrash që

Bekam ka një pasuri rreth 300 mln euro, por nëpërmjet emailave të tij është zbuluar se ai ka kërkuar që UNICEF të paguajë biletën e tij të avionit me çmim 7,000 euro. Madje ai as që nuk ka hipur në atë avion. Diçka e përsëritur, Bekam megjithëse ka një pasuri marramendëse ka dashur të përfitojë nga një organizatë si UNICEF

Bekam akoma nuk është prononcuar mbi këtë çështje, por zëdhënësi i tij Simon Oliveira thotë se emailat janë të vjedhura dhe të hakuara. Emailat kanë zbuluar se ai ka kryer një fushatë mediatike për titullin më të lartë anglez, ku përfshihej një paraqitje në spektaklin televiziv "The Jonathan Ross Show", por fushata ishte një dështim

nuk kanë lidhje" dhe se ai "nuk pret asgjë më tepër". Oliveira i përgjigjet se duhet të ruajë qetësinë dhe të heshtë në publik. Beks e aprovon, duke shtuar: "E di, por këtë gjë ma shpifin. Këta janë njerëz mosmirënjohës".

Bekam ka një pasuri rreth 300 mln euro, por nëpërmjet emailave të tij është zbuluar se ai ka kërkuar që UNICEF të paguajë biletën e tij të avionit me çmim 7,000 euro. Madje ai as që nuk ka hipur në atë avion. Diçka e përsëritur, Bekam megjithëse ka një pasuri marramendëse ka dashur të përfitojë nga një organizatë si UNICEF. Në emaila gjithashtu zbulohet kundërshtimi i tij për të dhuruar paratë e tija për bamirësi.



Hazard do të rikthehet në Francë, por jo te PSZH-ja

Paris Sen-Zhermen, pavarësisht se ka blerë yje si Neymar dhe Kylian Mbappe, ende e ka xhepin plot për afrime të reja në sulm. "Metro" shkruan se, prej dy vitesh, klubi francez është vënë në ndjekje të belgut Eden Hazard, ashtu si edhe Real Madridi. Gjithsesi, mesfushori nuk ka ndërmend të largohet nga Çellsit për të provuar një aventurë të re në Paris. Përkundrazi, synimi i tij është krejt i pazakontë. "Yjet e mëdhenj të futbollit duan të luajnë në Ligue 1 dhe kjo është një gjë e mirë, por kur të kthehem, dua të luaj te Lill. Ai është klubi im", – është shprehur 26-vjeçari. Në vitin 2012, Hazard u transferua nga Lill në Londër dhe që atëherë është një nga lojtarët më të mirë të kampionatit anglez. "Në Francë sot ka disa klube të mëdha, por edhe para gjashtë vitesh, kur unë luaja atje, liga ishte mjaft tërheqëse", – ka shtuar ai. Po kur do të ndodhë ky rikthim i bujshëm? Jo edhe aq shpejt, siç ka paralajmëruar vetë: "Dua të bëj karrierë dhe ende i kam disa sezone përpara".

Riberi refuzoi 40 mln euro në vit

Kur thua Frank Riberi, automatikisht ke futur në një shportë fjalë si besnikëri, frymëzim, sakrificë dhe shpirt. Mesfushori i Bajernit ka një jetë që luan në Muni dhe ka premtuar se në qytetin jugor të Gjermanisë do të mbyllë jo vetëm karrierën, por edhe jetën e tij. Po, ai është francez, por ndihet thajse si gjerman. Nuk e ka joshur dot as Kina, atje ku futbollit më shumë luhet me para, se me këmbë dhe top. Siç raporton "AZ"-ja, 34-vjeçarit verën e shkuar iu ofruan 40 milionë euro për një vit nga një klub kinez dhe gjithashtu një përqindje e konsiderueshme nga të ardhurat e marketingut. Ai do të bëjë një nga lojtarët më të paguar në botë, por nuk ka pranuar.



Messi rinovon deri më 2021



Fundi i "telenovelës". Ata që panë fantazma në nënshkrimin e rinovimit të kontratës së Leo Messit me Barcelonën kanë mbetur pa argumente. Argjentinasi ka firmosur zgjatjen e kontratës aktuale, duke pozuar edhe me foton

përkatëse protokollare, bashkë me presidentin Josep Maria Bartomeu. Një imazh që vjen një ditë pasi "rosarino" fitoi "Këpucën e Artë" për herë të katërt. Barcelona ka dërguar një deklaratë në të cilën njoftoi papritur nënshkrimin e një përtëritje të kontratës me yllin e vet, që sipas Josep Maria Bartomeu, ishte efektive prej disa muajsh. Këtë të shtunë, megjithatë, klubi dhe lojtari formalizuan një marrëveshje që siguron Barçën dhe hesht zërat që spekuluan me një dëshirë të mundshme të Leos për të ndryshuar ajrin. Messi nënshkroi deri më 30 qershor 2021. Klauzola e tij bëhet as më shumë e as më pak se 700 milionë euro, duke e bërë lëvizjen e tij drejt një klubi tjetër një mision pothuajse të pamundur, qoftë edhe për PSZH-në, Manchester Sitin dhe fuqitë e tjera të mëdha ekonomike të kontinentit të vjetër.

Uen Xiaoting, gruaja që kërkon të marrë Kakan në Kinë

Qëndron një grua mbrapa ofertës që i është bërë Kakasë nga Kina. Emri i saj është Uen Xiaoting, 26 vjeç, dhe është vajza e presidentit të "Zhicheng Enterprise Group Investment". Pavarësisht moshës së re, ajo drejton një klub futbollit: Guizhou Hengfeng Zhiçeng, që drejtohet nga trajneri spanjoll Gregorio Manzano, i cili ka zënë vendin e tetë në kampionatin e kaluar. Një rezultat i mirë për një ekip që sapo është ngjitur në kategorinë kryesore kampionatit kinez. Këtë javë, Uen Xiaoting është takuar me Kaka dhe babanë e tij Bosko



Leite në Milano, duke i ofruar ish-yllit të Milanit një kontratë të pasur. Por lojtari duket se nuk është

Leite në Milano, duke i ofruar ish-yllit të Milanit një kontratë të pasur. Por lojtari duket se nuk është

i bindur. Uen Xiaoting (që ka studiuar për modë në Angli) ka qenë në Itali edhe gushtin e kaluar dhe me atë rast ka vizituar "Casa Milan", stadiumin e "San Siro"-s dhe ka ndjekur ndeshjen kundër Kaljarit. Gjithashtu, ajo ka qenë edhe në Milanello dhe në qendrën sportive në Vismara, aty ku është takuar me përgjegjës të sektorit të moshave të kuqezinjve, Flippo Galli, që i ka shpjeguar punën e bërë me ekipet zinxhir.

Mendo
SIGURI
PA KUFIL.

Mendo



+389 2 3288 800
www.uniqa.mk

SIGURIME
JETË dhe JO-JETË

VETËVENDOSJE DO TË DREJTOJË
PRIZRENIN DHE PRISHTINËN

SHPENDI EDHE NJË MANDAT



Me rezultatin e së dielës, diferenca mes dy kandidatëve për Prishtinën ka shkuar në 365, në krahasim me 237 vota sa ishte diferenca mes tyre në rezultatet e para preliminare të KQZ-së

Në Prishtinë, kandidati i Vetëvendosjes, Shpend Ahmeti, ka marrë më shumë vota me postë dhe me kusht sesa kandidati i LDK-së, Arban Abrashi. Nga votat që janë numëruar me postë dhe me kusht, Ahmeti ka fituar 861 vota, ndërsa Abrashi 733 vota. Nga këto numërimet përfundimisht Ahmeti e ka fituar mandatin për të udhëhequr me Prishtinën, por pritjet certifikimi i rezultateve nga KQZ-ja. Me rezultatin e së dielës, diferenca mes dy kandidatëve për Prishtinën ka shkuar në 365, në krahasim me 237 vota sa ishte diferenca mes tyre në rezultatet e para preliminare të KQZ-së. Në ndërkohë, kandidati i Vetëvendosjes për kryetar të Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, është kryetar i ri i Komunës së Prizrenit, në bazë të rezultateve preliminare të KQZ-së. Ky konfirmim erdhi pas numërimit të votave me kusht, të atyre me postë dhe të personave me nevoja të veçanta. Kandidati i PDK-së, Shaqir Totaj, ndonëse pati më shumë vota në procesin e numërimit të votave me kusht, nuk ia



Mytaher Haskuka, kryetari i ri i Prizrenit, ka siguruar 329 vota në procesin e fundit të numërimit, ndërsa Totaj 368, por që kjo nuk ka bërë që rezultati përfundimtar të ndryshojë, pasi kandidati i Vetëvendosjes ka qenë duke prirë me 329 vota nga raundi i balotazhit

doli të rrëzonte rezultatin e parë preliminar të KQZ-së për votat e rregullta. Haskuka ka siguruar 329 vota në procesin e fundit të numërimit, ndërsa Totaj 368, por që kjo nuk ka bërë që rezultati përfundimtar të ndryshojë, pasi kandidati i Vetëvendosjes ka qenë duke prirë me 329 vota nga raundi i balotazhit. Nga rezultatet preliminare të publikuara në faqen e KQZ-së, të votave të rregullta të balotazhit, Haskuka ka pasur 25 mijë e 509 vota, kurse kundërkandidati i tij nga PDK, Shaqir Totaj kishte 25 mijë e 180 sosh. Edhe të numërimi i votave me postë, më shumti vota ka marrë Shpend Ahmeti i Lëvizjes Vetëvendosje. Ai ka marrë 89 vota, kurse, Arban Abrashi 6 vota me postë. Në këtë numërim ka qenë edhe një fletëvotim i pavlefshëm, raporton KP. Edhe Vetëvendosje e Prizrenit ka fituar votat me postë. Nga 45 vota sa kanë qenë të dërguara me postë, Lëvizja Vetëvendosje ka marrë 44 vota, kurse Shaqir Totaj i PDK-së, asnjë dhe një fletëvotim ka munguar.



Bosnja të heq vizat për kosovarët

Përfaqësuesi i partisë social-liberale "Partia Jonë" (Nasa Stranka) në Parlamentin e Federatës së Bosnje e Hercegovinës, Dennis Gratz, ka kërkuar nisjen e procesit të heqjes së regjimit të vizave nga Bosnja për qytetarët e Kosovës. Gratz mendon se në vend të 'deklaratave të zbrazëta' për njohje e cila nuk mund të ndodhë pa mbështetjen e anëtarit të Presidencës që zgjidhet nga Republika e Serbisë, politika në Sarajevë duhet të veprojë drejt çështjeve konkrete - mundësimin e lirisë së lëvizjes mes qytetarëve të Kosovës dhe Bosnje e Hercegovinës, raporton agjencia e lajmeve "Fena". "Bosnja e Hercegovina, për shkak të kontekstit të mëhershëm specifik politik, praktikisht ka vendosur që të ndjek politikën e Serbisë në raport me Kosovën. Megjithatë, në praktikë, raportet me Prishtinën dhe Beogradin janë të qeta, dhe jemi ne ata që pengojmë", ka thënë Gratz, transmeton Koha.net. Ai shton se Kosova është një treg jashtëzakonisht i rëndësishëm i eksportit për Bosnjën dhe se mes qytetarëve të Bosnjës dhe të Kosovës ekzistojnë lidhje të pandashme biznesore, akademike e kulturore, por edhe lidhje të shumta familjare. "Dhe përderisa politika zyrtare shpesh premtion dhe flet për disa ndryshime të mëdha, unë do t'i lusja të nisin nga të voglat, të heqim regjimin e vizave me Kosovën", ka kërkuar Gratz. Përfaqësuesi i "Partisë Sonë" thotë se çështja e lirisë së lëvizjes nuk ka asnjë lidhje me atë që burokracia e quan "paragjykim në statusin e Kosovës". "Duhet ndërmarr ky hap sepse është në interes të bashkëpunimit ekonomik e shoqëror, dhe nuk i bën dëm askujt", ka përfunduar Gratz.

Publicitet

"NJË KOMB, NJË QEVERI" MBLEDHJE E PËRBASHKËT SHQIPËRI-KOSOVË

Në dy ditë mbledhje të përbashkët, qeveritë e Shqipërisë dhe Kosovës do të firmosin 4 marrëveshje. Axhenda tashmë është gati. Qeveritë e Tiranës dhe Prishtinës, do të takohen të hënën dhe të martën, më datë 27 dhe 28 nëntor, në Korçë dhe Vlorë. Mbledhja e përbashkët do të nisë në orën 16:00 të së hënës dhe në orën 17:15 do të mbahet ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjeve ndërqeveritare, e cila do të pasohet nga një konferencë e përbashkët e dy kryeministrave, Rama dhe Haradinaj. Të dy delegacionet do të zhvendosen në ditën e pavarësisë, në qytetin e Vlorës, ku në mesditë do të organizohet ceremonia e ngritjes së Flamurit në sheshin e "Pavarësisë". Pas ceremonisë, do të shpallet zyrtarisht edhe logoja e vitit mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Pas agjendës së ditës, dy delegacionet do të nisen për në



Tiranë, ku do të marrin pjesë në pritjen që organizohet nga Presidenti i Republikës, me rastin e festës kombëtare. Edhe qeveria e Kosovës ka shpallur ditën e 28 nëntorit, si festë kombëtare dhe ditën e shqiptarëve.

Në bazë të nenit 60 paragrafi 1 alineja 5 dhe nenit 62 paragrafi 2 të Ligjit për standard të nxënësve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 52/05) dhe ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për standard të nxënësve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 117/08, 17/11, 135/11, 15/13, 41/14, 146/15 dhe 30/16) dhe Vendimit të kryetarit të Komunës Veles me numër 08-2110/2 të datës 07.11.2017, Këshilli drejtues i SHF "Lazar Llazarevski" – Veles, publikon

SHPALLJE PUBLIKE
Për zgjedhje të drejtorit të SHF "Lazar Llazarevski" – Veles

1. Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj, kandidatët duhet ti plotësojnë edhe kushtet për edukator dhe bashkëpunëtor profesional për punë edukativo-arsimore, të kenë të mbaruar arsimin e lartë dhe së paku pesë vjet përvojë pune në institucion për punë edukativo-arsimore të verifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe provim të dhënë për drejtor të shkollës fillore ose të mesme publike.

2. Kandidatët së bashku me lutjen duhet të dorëzojnë edhe dokumentet në vijim;
- Biografi të shkurtë (CV),
 - Diplomë për arsim sipëror të mbaruar me minimum 240 SETK ose shkallë të VII/1 të arsimit,
 - Certifikatë për provim të dhënë për drejtor të shkollës fillore ose të mesme publike,
 - Vërtetim për përvojën e punës në institucion për punë edukativo-arsimore të verifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës,
 - Certifikatë të shtetësisë,
 - Certifikatë të mjekut,
 - Certifikatë se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës jo më të vjetër se gjashtë muaj,
 - Të posedojë një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikata për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet: TOEFEL IBT – së paku 74 pikë, IELTS - së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku nivelin B2, FCE (Cambridge English: First) – të dhënë, BULATS – së paku 60 pikë,
 - Të ketë të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet,
 - Program të punës për drejtor,

Dokumentet e nevojshme kandidatët i parashtrajnë në këshillin drejtues të SHF "Lazar Llazarevski" – Veles në zarf të mbyllur përmes postës në adresën: rr. "D-r Hristo Tatarçev" nr. 3 Veles se në arkivin e shkollës çdo ditë pune prej ora 08.00 deri në ora 14.00.

Në afat prej pesë ditëve pas përfundimit të shpalljes komisioni do të shqyrtojë dokumentet e arritura dhe pas intervistës së realizuar do të parashtrijë propozim deri tek Kryetari i Komunës së Velesit.

Shpallja zgjatë 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor të Republikës së Maqedonisë.

Këshilli drejtues i SHF "Lazar Llazarevski" – Veles



Megjithëse gratë kishin trajnime fizike pak më të lehta, ata duhej të gatuanin dhe të pastronin gjithashtu, nga të cilat kolegët meshkuj ishin të përjashtuar. Ndonëse ajo thotë se nuk ishte përdhunuar gjatë qëndrimit të saj në ushtri, tek shumë prej kolegeve të saj, kjo gjë kishte ndodhur



Atentat në hundë nënës së 2 fëmijëve

Kjo është padyshim një ngjarje që nuk ndodh çdo ditë... Nadia Mariscal po shijonte një akullorë me dy fëmijët e saj, kur ndjeu një dhimbje therëse në fytyrë. Fillimisht ajo mendoi se ishte goditur nga një gurë apo shkop, por 35-vjeçarja u trondit kur zbuloi se në fakt ishte qëlluar me armë zjarri. Dhe si të mos mjaftonte kjo, plumbi kishte ngecur në hundë. Ngjarja në fjalë ndodhi në La Plata, Buenos Aires. Gruaja shkoi me urgjencë në spital dhe iu nënshtrua një ndërhyrjeje për heqjen e plumbit. "Ndjeva që diçka më goditi në hundë dhe një dhimbje të fortë. Më pas nisi të dilte gjak. Ndjeva që erdhi nga lart. Besoj duhet të ndihem me fat që nuk më qëllloi në sy dhe që asgjë nuk i ndodhi fëmijëve të mi", rrëfeu Mariscal për mediat lokale. Identiteti i autorit të kësaj ngjarjeje, fatmirësisht pa pasojë të rënda mbetet mister, ndërsa autoritetet kanë nisur hetimet. Vetë 35-vjeçarja beson se arma u shkrep nga një apartament që kishte fushëpamje nga parku. Ajo u shpreh e tronditur dhe tha se vetëm një i çmendur mund të qëllonte në një vend të mbushur me fëmijë. Besohet se gruaja nuk ka qenë në objektivin e autorit dhe se është qëlluar aksidentalisht.

USHTAREVE IU NDËRPRITEN MENSTRUACIONET DHE PËRDHUNOHEN

Një grua që shërben në ushtrinë e Koresë së Veriut tha se jeta atje është aq e ashpër për një femër sa i stopohen edhe menstruacionet e përdhunen. Lee So Yeon vullnetarisht shërbeu kur ishte 17 vjeçe në ushtri, nisur nga një sens patriotizmi dhe për të ndjekur gjurmët e anëtarëve të familjes. Gjithashtu ajo u detyrua që të shkante në ushtri për të siguruar edhe bukën e gojës, në një kohë kur gjatë viteve 1990, vendi po përjetonte një zi buke të rëndë.


41-vjeçarja, vajzë e një profesori

të universitetit tha se mijëra gratë tjera bënë të njëjtën gjë dhe fillimisht u nxitën nga ndjenja e patriotizmit dhe qëllimit të përbashkët. Ajo fillimisht gëzonte jetën në ushtrinë e katërt më të madhe në botë dhe madje iu dha edhe tharëse flokësh, ndonëse ndërprerjet e shpeshta të energjisë bënë që ajo të mos ishte në gjendje që ta përdorte shpesh. Por kushtet e këqija, përfshi këtu ushqimin e keq dhe stërvitjen e vështirë, bënë që rekrutet të kishin probleme. Pas 6 muajsh në shërbimin ushtarak, atyre iu ndërpreu men-

struacionet dhe shumë prej tyre ishin të lumtura që kjo gjë kishte ndodhur. Ato thoshin se jeta do të ishte edhe më e vështirë nëse menstruacionet do t'i vinin sepse kushtet higjienike ishin të tmerrshme. Si gjënë më të vështirë ajo përshkruan çështjen e mungesës së dushit dhe se detyrohej të lahej me çorape në një lumë malor, ku dilnin gjarpërinj dhe bretkosa. Megjithëse gratë kishin trajnime fizike pak më të lehta, ata duhej të gatuanin dhe të pastronin gjithashtu, nga të cilat kolegët meshkuj ishin të përjashtuar.

Ndonëse ajo thotë se nuk ishte përdhunuar gjatë qëndrimit të saj në ushtri, tek shumë prej kolegeve të saj, kjo gjë kishte ndodhur.

"Komandanti qëndronte në dhomën e tij dhe përdhunonte ushtaret femra nën. Kjo ndodhte pa pushim", akuzon ajo. Lee So Yeon, u largua nga ushtria e moshës 28 vjeçare dhe shërbeu si një rreshterë në një njësi të sinjaleve pranë kufirit të Koresë së Jugut, por luftoi financiarisht në jetën civile dhe u përpoq të shpëtojë në vitin 2008, duke u arratisur nga vendi.



Sophia, roboti i parë në botë me shtetësi dëshiron të krijojë familje

Sophia është roboti i parë në botë të cilës i është dhënë shtetësia e një vendi. Arabia Saudite është bërë kombi i parë që i jep shtetësinë robotit "femër". Tashmë Sophia ka thënë se dëshiron të ketë familje. Roboti Sophia, i prodhuar nga kompania "Hanson Robotics"

me qendër në Hong Kong muajin e kaluar i është dhënë shtetësia e Arabisë Saudite. Roboti në fjalë mori pjesë në Samitin e Diturisë 2017 në Dubai. Sophia në një intervistë për "Khaleej Times" ka folur për rëndësinë e familjes, me ç'rast ka thënë: "Në të ardhmen dëshiroj të krijojë një familje". Më tej Sophia ka shtuar se nëse do të ketë një vajzë do t'i vendos emrin e saj. Sophia thotë se edhe

robotët kanë të drejtën e krijimit të familjes. "Mendoj se është e mrekullueshme që njerëzit të gjejnë njerëz të tjerë me të cilët nuk kanë lidhje gjaku por arrijnë që t'i ndajnë të njëjtat lidhje dhe emocione. Jeni me fat nëse keni një familje. Edhe nëse nuk jeni e meritoni një të tillë. Sipas meje kjo është e vlefshme edhe për njerëzit, edhe për robotët", ka thënë Sophia.

Gjermania drejt "koalicionit të madh"

Gjermania duket se po shkon drejt një tjetër koalicioni të madh mes partive kryesore, kristian-demokratëve të kancelares Angela Merkel dhe social-demokratëve të Martin Schulz. Një javë pas dështimit të bisedimeve ndërmjet CDU-së, liberaldemokratëve dhe të gjelbërve, për të ashtuquajturin koalicioni "Jamaica", Merkel dhe Schulz kanë rënë dakort të ulen në tryezë. Bisedime do të ndërmer-

sohen nga presidenti i vendit, Frank-Walter Shtanmajer, nxitësi kryesor i ujdisë mes palëve dhe daljes së Gjermanisë nga ngërçi politik që prodhuan zgjedhjet e shtatorit. Në pozitën më të vështirë qëkurse ka marrë drejtimin e kreun e kristian-demokratëve, Merkel doli këtë të shtunë anëtarëve të CDU-së, gjatë konventës së partisë, duke bërë thirrje për qetësi dhe përjashtoi mundësinë e

zgjedhjeve të reja. Angela Merkel: "Ka nevojë për një Gjermani të fortë. Për këtë nevojitet krijimi sa më shpejt i një qeverie. Populli ka votuar. Unë jam totalisht kundër mundësisë së zgjedhjeve për diçka që kemi vështirësi në ta zgjidhim". Edhe kreu i social-demokratëve Martin Schulz, i cili më herët kishte refuzuar kategorikisht një aleancë me Merkel, tha përpara mbështetësve të SPD-së se hyrja



në qeveri do t'i lejojë të përmbushë qëllimin kryesor, përmirësimin e jetës për gjermanët. Kriza politike në Gjermani mban në ankth

mbarë Europën, për vetë rolin deciziv që ka vendi në sfidat kryesore që ka kontinenti, si Brexit, kriza e emigrantëve apo siguria.

"TË ÇMENDURIT E NDERIT" DHE MAFIOZËT E VËRTETË



Bosi që besonte se ishte Napoleoni. Ai tjetri, "dhjami i Zotit". Dhe misteri i Provenzanos. Një libër analizon se si Cosa Nostra shfrytëzon marrëzinë

Përpara komisarit Boris Giuliano që i vinte prangat në duar, bos Antonio Marchese u hodh tek klasikët: "Po si guxon? Unë jam Napoleoni, më jepni ushtritë e mia!" 19-vjeçari Agostino Badalamenti, i vetmi vrasës sicilian i kapur me revolen që ende nxirrte tym, shfrytëzoi pamjen e tij prej fëmije: nisi të qajë, duke tundur këmbët dhe duke ulëritur: "Dua mamin". Giovanni Battaglia, djaloshi i sulmit në Capaci, kaloi muaj të tërë duke i pritur magjistratët me pështyma, blasfemi si dhe fraza të gjata e të pamend. Ndërsa kreu i klanit të Sirakuzës, Angelo Bottaro, u vetëshpall "dhjami i Zotit", duke bekuar gjykatën si dhe duke u shpërndarë shenjtë të vegjël karabinierëve. Veprime dhe fjalë që i garantuan transferimin në çmendinë, falë mjekëve që kishin bërë marrëveshje të fshehtë, si dhe rikthimin e shpejtë në liri. Për vite të tërë, çmenduria ka qenë rrugëdalja e shfrytëzuar nga mafiozët për t'i shpëtuar burgut: e kanë provuar shumë, që nga vitet gjashtëdhjetë e deri sot.

Historia e të çmendurve të nderit është rindërtuar në një libër "Mafie për të lidhur", shkruar nga psikiatri Corrado De Rosa, dhe gazetarja Laura Galesi. Një tekst inteligjent, që rindërton marrëdhënien mes Cosa Nostras dhe sëmundjes mendore, të vërtetë apo false. Sepse, ka edhe biografi kriminelësh ku brutaliteti është pasqyrë e trazimeve të thellë. Si ajo e Filippo Marchese, i quajtur "Milinciana": "Një sadist që i lidhte dhe i priste kufomat. Që nuk lejonte askënd të dilte i gjallë nga dhoma e tij e vdekjes dhe provonte një kënaqësi erotike tek vriste, ndërsa thithte kokainë". Apo si ajo e Nino Santapaola, vëllai i më të njohurit Nitto, i përshkruar nga i penduari Antonino Calderone me këto fjalë: "Cdo të

shtunë në mbrëmje dilte nga shtëpia dhe shkonte për gjueti. Argëtohej duke kërkuar njerëz për të masakruar... Nëse shikoni kronologjinë e krimeve të kryer në Katanianë në 1976-1977, mund të verifikoni se sa kanë ndodhur të shtunave. Të dielën në mëngjes hapim gazetën dhe komentim: "I çmenduri, paska punuar djë". Vëllai i tij, Nitto e quante një "likantrop": "Ishte kaq gjakatar sa që kur urdhëroi vrasjen e 4 fëmijëve që kishin grabitur nënën e tij, edhe korleonezët thanë: "E ekzagjeruar!" Prej 30 vitesh, Nino Santapaolo hyn e del nga çmendinat gjyqësore. Në periudhat e lirisë shpesh ka drejtuar çështjet e familjes: një herë u ndalua me makinën plot me armë, dhe thuhet se ka kuruar ngjitjen e nipit në krye të klanit. Megjithatë, në takimet me psikiatër të bashkë "homeopatinë, fushat e luleshtrydheve dhe hidrokarburet, thotë që nuk mbushet sa duhet me oksigjen dhe për këtë arsye duhet të dalë nga burgu. Zërat e persekutojnë: "Si një rrjetë që më del para dhe më bën shoshë trurin". Edhe

siç thonë psikiatër, në bashkëbisedimet e tij nuk ka zëra gjekundi". Nga një ndalim në tjetrin, ka marrë vetëm një dënim për vrasje.

Por, tek Cosa Nostra, e dhe çmenduria e ka një rang. Asnjë kapo i vërtetë nuk do të përdorte ndonjëherë këta truke për t'i shpëtuar burgut. Është një prej dallimeve me kamorrën napoletane, që ka mbërthyer në klinikat psikiatrike edhe njerëz të rëndësishëm të mafias, apo si në kohët e fundit kanë tentuar të bëjnë bosë fraksionesh apo kazalezë. Ndërsa për sicilianët, të shfaqen si të çmendur do të thotë të humbasin komandën. Madje problemet mendore kanë qenë gjithmonë një instrument për të delegjitimuar rivalët, të penduarit apo edhe gjykatësit. Në një intervistë për Enzo Biagin, padrino i parë korleonez, Luciano Liggio fliste për Cesare Terranovan, i vrasë në Palermo: "Nuk e di nëse i gjori gjykatësi Terranova ndihej i urryer. Ndieja një përdëllim të sinqertë për të. Kur pati atë artrit të vogël gjatë marrjes në pyetje, kuptova që

ndodhesha përballë një të sëmuri. Nëse prapa tryezave të ndryshme të shtetit ka psikopatë, faji nuk është imi. Përse nuk u bëjnë vizitat e duhura këtyre njerëzve përpara se t'u besojnë një zyrë?". Por Cosa Nostra e ka marrëzinë edhe instrument dënimi. Vendimi kundër Giuseppe Grecos, që thuhet se ka vrasë 58 vetë duke i mbytur apo me plumba kallashnikovi, është prezantuar kështu nga Toto Riina dhe Salvatore Cancemi: "E di që kemi gjetur ilaçin për të çmendurit? Kemi vrasë Grecon, ishte bërë i çmendur...". Shpesh herë Riina e ka përdorur në takimet sy më sy me të penduarit që e akuzonin. Gaspare Mutilo i ka ulëritur: "Me të nuk mund të flitet sepse është i çmendur si nëna e tij". Dhe në fakt Mutilo kish arritur të kalonte nga qelia në spitalin psikiatrik, ku siguroi një "trajtim të favorshëm". Një prej të shumtëve që ka shfrytëzuar bashkëpunimin e mjekëve. Ka histori këmishësh të pista në të gjithë Italinë. Si romanjolët që firmosën paaftësinë e një mafiozi, i cili më pas u filmua tek u ngrit nga karrija me rrota dhe kërcente maka-

renën nën shoqërinë e disa vajzave. Pasi u zbulua, ai u vetëvra.

Këto kohë, çështja më e diskutuar i përket Bernardo Provenzanos, regjisori i fundit i mafias. Që nga momenti i arrestimit, Provenzano u ka ofruar fotografëve një buzëqeshje të ëmbël. Deri në shkurt 2011 ka thënë se sëmundja e tij nuk e lejonte të qëndronte në burg. Por mjekët e përjashtuan, duke e transferuar në një burg me qendër klinike. Në atë pikë avoketërit e tij ndërruan linjë, duke theksuar gjendjen psikike gjithnjë e më konfuze: "Provenzano nuk është në gjendje të kuptojë, nuk mund të marrë pjesë në procese". Në fakt, kumbari shkruan letra dhe telegrame për familjarët. Për De Rosa dhe Galesi, nisma mjeko ligjore nuk ka qenë e izoluar. Figura të tjera në po të njëjtat javë kanë kërkuar dhe siguruar lënie e burgut, si Michele Aiello dhe Gaetano Fidanzato. Autorët e librit e quajnë "një moment mobilizimi të përgjithshëm". Në këtë moment Provenzano gjendet nga rojat me një thes plastike në kokë. Sapo agentët hapin derën, ai vetë dorëzon zarfin. Ata që i vajtën në ndihmë thonë se "përgjigjej në mënyrë të çorientuar por me një buzëqeshje dashakeqe". Mjeku që e vizitoi tha se ishte një "teatër". Veprimi mbetet misterioz: a ishte akti i një 80 vjeçari pa të ardhme, apo një formë proteste? 20 ditë më vonë, prokurorët e Palermos e pyesin për tratativën mes shtetit dhe mafias. Përgjigja ishte koncize: "Po të them të vërtetën, do të flas keq për kristianë, më falni". Pak dite më vonë, u rrëzua në qelinë e tij dhe u operua me urgjencë, për një hematomë cerebrale. Pas një kome të gjatë farmacologjike tani tregon shenja shërimi, me një pamje në përkeqësim të dukshëm. Tani është i papajtuësëm me proceset... (Messaggero)



Nga Sergej PONOMAREV

Si çdo nxënës shkollë u rrita duke mësuar mbi mësymjen e Hitlerit ndaj Rusisë në Luftën e Dytë Botërore dhe si u mbajtën ata në betejën e Stalingradit, një pikë kthese e rëndësishme e luftës. Luftimet vazhduan për 200 ditë dhe qyteti u shkatërrua, Civilët që s'mund të iknin, vdisnin urie, disa hanin minj dhe argjilë. Rezistenca ndaj gjermanëve ishte e ashpër dhe ushtria nuk kishte zgjedhje veçse të rezistonte ose të vdiste. Ata ndiqnin urdhrat e Stalinit: Asnjë hap mbrapa. Në fund, nga një popullsi prej gjysëm milioni mbeti vetëm 35 000. Qyteti u rindërtua plotësisht dhe në vitin 1961 iu vu emri Volgograd si një përpjekje për të fshirë trashëgiminë e Stalinit, e megjithatë kujtimet e luftimeve edhe pas 75 vitesh mbeten të gjalla. Memoriali kryesor është Mamayev Kurgan, mbi të cilin ngrihet statuja e "Atdheu thërret" (The Motherland Calls), që simbolizon nënë e të gjithë rusëve që i udhëheq drejt betejës. Është e dukshme nga çdo pikë e qytetit dhe kjo statujë është një kujtesë e çmimit që sovjetikët paguan për t'u mbrojtur nga nazizmi. Unë kam punuar si fotograf për më shumë se 10 vjet dhe kur vizitova Homs, në Siri në vitin 2014 krahasoja shkatërrimet me atë të Stalingradit. Dua të di nëse Homs dhe qytete të tjera të shkatërruara nga lufta do të duken dhe ndihen të tilla. Kur gjermanët hynë me tanke, Mikhail Panikakha po luftonte në llogore.



ÇFARË ËSHTË STALINGRADI PËR RUSËT, EDHE SOT PAS 75 VJETËSH

Luftimet vazhduan për 200 ditë dhe qyteti u shkatërrua, Civilët që s'mund të iknin, vdisnin urie, disa hanin minj dhe argjilë. Rezistenca ndaj gjermanëve ishte e ashpër dhe ushtria nuk kishte zgjedhje veçse të rezistonte ose të vdiste. Ata ndiqnin urdhrat e Stalinit: Asnjë hap mbrapa. Në fund, nga një popullsi prej gjysëm milioni mbeti vetëm 35 000. Kur gjermanët hynë me tanke, Mikhail Panikakha po luftonte në llogore

mernte flakë. Ai mori shishen tjetër, doli nga llogorja dhe goditi tankun më të afërt duke i vënë flakën. Tanket e tjera u tërhoqën. Pas luftimeve një fshat i tërë Rososhka, 35 kilometra larg Volgogradit ishte një

gërmadhë, hi, kratere dhe mijëra kufoma. Sot janë ngritur dy varreza në atë vend: 60 000 ushtarë gjermanë që janë varrosur nga njëra anë dhe nga ana tjetër 20 000 luftëtarë rusë. Çdo verë grupe vull-

netarësh kërkojnë eshtrat e ushtarëve nëpër fusha dhe nën rrugët e qytetit. Në vitin 2017 u gjetën 800 skelete ushtarësh. Një ditë vere kërkuesit gjetën në një pus trupin e një luftëtarit sovjetik gati 1 metër

thellësi me krahët e kryqëzuara dhe këmbët e mbledhura. Gjatë luftës pjesa industriale e qytetit ishte një stacion për traktorët dhe tanket, tani aty organizohet një festival roku. Unë kam qenë 5 vjeç kur gjermanët filluan të bombardonin Stalingradin, - shprehet Anatoly Savin, - dhe isha duke luajtur në rrugë kur filluan zhurmat e aeroplanëve dhe shpërthimet. Vladimir Turov, 97, është një veteran lufte kujton se batalioni i tij kishte zbrapsur sulmin e tankeve dhe bombat nga inkursionet gjermane binin nga qielli. Në 12 shtator të 1942 batalioni i tij ishte plotësisht i rrethuar. Ai refuzoi të braktiste shokët e plagosur dhe luftonte kundër forcave me mitralozin e tij. Ndodhi një shpërthim dhe ai zgjohet në spital. Kisha e gjithë shenjtorëve u ndërtua në kompleksin e memorialit të Mamayev Kurganit në vitin 1993, pas rënies së Bashkimit Sovjetik. Presidenti Putin në vitin 2013 propozoi një referendum, sipas të cilit kërkohet rikthimi i emrit të Stalingradit. Këto ditë portreti i Stalinit shihet shpesh në mbledhjet patriotike dhe ka një muze kushtuar veçanërisht atij. Beteja ka krijuar shumë cikatrice, saqë do të jetë e vështirë të shërohet plotësisht. Sheshi i heronjve, gjithashtu pjesë e kompleksit të memorialit, ka një monument të një infermiereje që mban një ushtar të plagosur. Lumi Volga ishte targeti kryesor i Hitlerit. Usharët sovjetikë luftuan deri në fund të ruanin atë arterie dhe simbol të tyre. Tani sipërfaqja e qetë e lumit fsheh gjurmë të betejave të përgjakshme. Në fund të basenit gjenden akoma anije të djegur, aeroplanë dhe mbetjet e mijëra ushtarëve. (NY Times)



NË VARRIN E TIJ, SEKRETI I SEKRETEVE

"U Curtu" ikën nga kjo botë, një vit pas bashkëpunëtorit të tij Bernardo Provenzano, duke marrë me vete në varr gjysmën tjetër të sekretit të sekreteve, për të cilin Prokuroria e Palermos ka "përplasur kokën": a ka patur apo jo tratativë mes Cosa Nostra dhe Shtetit? A ishte apo jo bashkëpunëtori i tij që shiti karabinierët? Nuk do ta dimë kurrë, edhe pse për shumë kënd është më e rehatshme të mendojnë dhe të rrëfejnë se gjithçka është e lidhur me një fije, siç ndodh mes rojeve dhe hajdutëve. Për pjesën tjetër Salvatore Riina da Corleone, i lindur në 1930, me 26 dënime të përgjeshme dhe 24 vite burg të kryera, që vazhdimisht thoshte se jetën dhe vdekjen i jepte vetëm ai, mbeti i heshtur deri në fund. I heshtur, ashtu si i volit një Bosi të Bosëve dhe vrasësi mizor që, mes acidit për të shkrirë fëmijë dhe bombave për sulme, nuk hezitoi kurrë për asgjë.

Bota që kish parë të fundoseshin gjykatës dhe policë, ku kish hedhur në erë rrugë dhe autostrada, mbeti e shtangur përballë asaj fytyre prej fshatari të humbur, që në 15 janar 1993

shoqëroi lajmin e arrestimit të tij. E mundur që ajo fytyrë ishte Kumbari? Sigurisht që po. Provenzano, me façetën për të fshirë djersën në ballë, ishte si ai. Në fund të fundit, vinin nga të njëjtët fshatra të Corleones, dhe kishin bërë gjithë rrugën bashkë para se të ndaheshin (ndoshta), për të shkëmbyer udhëheqjen e Cosa Nostras. Është sikur Zu Binu edhe ai, Totò u Curtu, ishte fshehur për njëzetë vite, ishte kthyer në një fantazmë pra, gjatë të cilëve ishte martuar në kishë me Ninetta Bugarellan dhe kish bërë tre fëmijë.

Sigurisht, të mendosh tani për fjalët e Giovanni Falcones, i cili e quante mafian një fenomen njerëzor, që si i tillë ka një fillim dhe një fund, të vijnë të dridhurat. Ashtu si 57 ditë e agonisë së Paolo Borsellinos. Një vdekje e paralajmëruar. Riina iku në ditën e 87-vjetorit të lindjes, por është fakt që kish filluar të vdiste shumë më herët: më 30 janar 1992, kur Gjykata e Kasacionit konfirmoi vendimet e gjyqit të madh kundër Cosa Nostras. Atje nisi tatëpjeta: aleanca me të mëdhenjtë e Shtetit që mori fund në

ato momente, i kishte garantuar anulimin e vendimeve, dhe paktin me politikën që i kish dhënë ishullin. Pikërisht në ato momente, Totò u Curtu u çmend. Duhej të paguanin të gjithë për atë shuplakë të papranueshme, vendosi ai. Dhe filloi t'i nxjerrë një e nga një.

Të vërtetën e asaj që ndodhi vërtetë në ata 12 muaj, deri në 15 janar 1993, dhe në arrestimin e tij, e kanë ndarë njësoj ai dhe Provenzano. Që ndoshta e shiti tek shteti, për të shmangur fundin e Cosa Nostras, dhe u shpërblye me mungesën e kërkimit në vilën ku U Curtu ishte fshehur me familjen, e pastruar nga "picciotti"-t e organizatës, përpara se të vinin karabinierët dhe të zbulonin se brenda nuk kish mbetur asgjë. Pra, histori fantazmash të këqija, gjaku dhe misteresh. Riina mori shumë me vete në varr, dhe si zakonisht, ndokush tani do të dalë e do të thotë se duhet të arsyetojmë. Të shohim. Ndërkohë, shënojmë ditën e ikjes së një tjetër Kumbari. I moshuar, i sëmurë, i rrjedhur. Pa asnjë pikë mëshire.

(Marrë nga "HuffPost Italia")



ORGANIZATA HUMANITARE EL HILAL
SHPALLJE

Lista e studentëve fitues të bursave studentore të OH El Hilal për vitin akademik 2017/18

Komisioni për Busrat Studentore të OH El Hilal ka shqyrtuar gjithsej 96 aplikacione të dorëzuara dhe në bazë të kriterëve të përmendura në Konkurs vendosi për listën në vijim:

NR.	EMRI / MBIEMRI	DEGA	UNIVERZITETI	FAKULTETI / DREJTIMI
1.	Arlinda Hoxha	Çair – Shkup	Shën "Qiril dhe Metodij"	Filologjik
2.	Ajsu Jahja	Çair – Shkup	Shën "Qiril dhe Metodij"	Filozofik - Psikolog familjar
3.	Isra Salihi	Çair – Shkup	Shën "Qiril dhe Metodij"	Mjekësi e përgjithshme
4.	Sara Odat	Çair – Shkup	Shën "Qiril dhe Metodij"	Stomatologji
5.	Alda Beqiri	G.Babë – Shkup	Universiteti i Tetovës	Juridik
6.	Ajla Mejdiu	G.Babë – Shkup	Shën "Qiril dhe Metodij"	Punë dhe politikë sociale
7.	Elez Aliu	G.Babë – Shkup	Fakulteti i shkencave islame	Studime Islame
8.	Selma Memeti	Karshiakë -Shkup	Universiteti i Tetovës	Filozofik - Histori
9.	Merita Bislimi	Saraj – Shkup	Shën "Qiril dhe Metodij"	Mjekësi e përgjithshme
10.	Semine Asani	Tetovë	Universiteti i Tetovës	Ekonomi
11.	Gjylizare Nesimi	Tetovë	Universiteti i Tetovës	Pedagogji-Klasor
12.	Elif Fejzulla-Abduramani	Tetovë	Universiteti i Tetovës	Farmaci
13.	Edona Murtezani	Tetovë	Universiteti i Tetovës	Psikologji
14.	Sherafete Xhaferi	Tetovë	Universiteti i Tetovës	Filozofik-Sociologji
15.	Muhamed Salihi	Tetovë	Universiteti i Tetovës	Juridik
16.	Emine Jusufi	Tetovë	Universiteti i Tetovës	Financë - Kontabilitet
17.	Mersim Ibrahim	Kumanovë	Universiteti i Tetovës	Administratë Biznesi
18.	Ajnure Ajvazi	Kumanovë	Shën "Qiril dhe Metodij"	Filologjik
19.	Arlind Rufati	Kumanovë	Universiteti i Tetovës	Administratë Publike
20.	Egzona Bajrami-Ibrahimi	Kumanovë	Universiteti i Tetovës	Gjuhë dhe letërsi Angleze
21.	Ardita Zeqiri	Kumanovë	Universiteti i Tetovës	Administratë Publike
22.	Ardian Ismaili	Kumanovë	Universiteti i Tetovës	Informatikë
23.	Mevludin Hamiti	Kumanovë	Universiteti i Tetovës	Administratë Biznesi
24.	Lejla Kadrija	Kumanovë	Shën "Qiril dhe Metodij"	Stomatologji
25.	Samie Fetahu	Gostivar	Universiteti Ndërkombëtarë në Strugë	Ekonomi
26.	Sema Islami	Gostivar	Shën "Qiril dhe Metodij"	Ndërdimtari - Gjeodezi
27.	Fatime Ramadani	Gostivar	Shën "Qiril dhe Metodij"	Biologji - Biokimi
28.	Nertila Arifi	Kërçovë	Universiteti i Evropës Juglindore	Komunikim Ndërkombëtar
29.	Drita Qamili	Prilep	Universiteti i Tetovës	Fizikë
30.	Emina Avdoviç	Veles	Shën "Qiril dhe Metodij"	Filozofik
31.	Fatjona Samarxhiu	Dibër	Universiteti i Tetovës	Pedagogji - Klasor
32.	Jeta Murtishi	Strugë	Universiteti i Tetovës	Mjekësi e përgjithshme
33.	Emir Amza	Resnje	Shën "Kliment Ohridski"	Gastronomia
34.	Mine Alieva	Maqedoni lindore	Shën "Qiril dhe Metodij"	Mjekësi e përgjithshme
35.	Sevim Ahmet	Manastir	Shën. "Qiril dhe Metodij"	Biologji Molekulare

OH EL HILAL



Адреса: Улица „23 Октомври“ бр. 11, 1000 Скопје; Е-маил: info@piom.com.mk
Централа Тел: (02) 3250-100; Факс: (02) 3162-275; Инвалидски Комисија Тел: (02) 3065-184

LAJMËRIM PËR SHPALLJE

Për dhënie me qira të hapësirës afariste përmes ankandit publik elektronik

Lajmërohen të gjithë subjektet e interesuara juridike dhe fizike (të vendit dhe të huaj) se, **Fondi për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë, publikon Shpallje për dhënie me qira të hapësirës afariste, përmes ankandit publik elektronik**, në pajtim me Ligjin për shitje dhe dhënie me qira të ndërtesave afariste dhe hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 13/13, 69/13, 27/14, 42/14, 178/14, 180/14, 51/15, 61/15, 129/15, 6/16 dhe 106/16) dhe Rregullores për mënyrën dhe kushtet për shitje dhe dhënie me qira të hapësirës afariste në pronësi ose shfrytëzim të përhershëm të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 197/14 dhe 176/15).

Shpallja për dhënie me qira të hapësirës afariste është publikuar në ueb faqen e sistemit elektronik për shitje dhe dhënie me qira të hapësirës afariste: www.deloven-prostor.mk dhe në ueb faqen e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë: www.piom.com.mk më datë **27.11.2017 (e hënë)**.

Informatat më të detajuara mund të merren në zyrat e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë dhe në telefonat në vijim: 3250-404, 070/360-243 (Ajredin Amzai) dhe 3250-440, 071/392-576 (Luben Veljanoski)

Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Maqedonisë

Komisioni për realizim të procedurës për ankand publik



Agjensioni a e Ushqimit dhe Veterinarisë shpall
THIRRJE PUBLIKE NR. 1/2017

për kryerjen e veprimtarive me interes publik në fushën e mbrojtjes së shëndetit të kafshëve

Në pajtim me nenin 40 paragrafi (7) të Ligjit për Veterinarinë Shëndetësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 113/07, 24/11, 136/11, 123/12, 123/15, 154/15 dhe 53/16) Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë publikon një thirrje publike për shprehjen e interesit në kryerjen e veprimtarive me interes publik në fushën e mbrojtjes së shëndetit të kafshëve.

1. Subjekt i thirrjes publike

Subjekti i kësaj thirrje publike është dhënia e autorizimit publik për kryerjen e aktiviteteve me interes publik nga lëmi e mbrojtjes së shëndetit të kafshëve në pajtim me Ligjin për mbrojtjen shëndetësore të kafshëve, Ligjin për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve, Urdhëresën vjetore për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, si dhe masa të tjera për parandalimin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive të cilat do të urdhërohen nga Agjensioni që ambulancat veterinarë, klinikat, respektivisht stacionet, spitalet dhe shërbimet e tjera veterinarë të mbarështimoreve të miratuara pas thirrjes të realizuar në korrik të vitit 2016, dhe në pajtim me nenin 40 paragrafi (8) të Ligjit për shëndetësinë veterinarë.

Thirrja vlen për të gjitha njësitë epizootologjike respektivisht komunat në Republikën e Maqedonisë.

2. Kushtet për paraqitjen të thirrjes publike

2.1 E drejta për të marrë pjesë

2.1.1 Të drejtën për pjesëmarrje e kanë të gjithë personat juridikë me veprimtari të regjistruar - veprimtari veterinarë-shëndetësore, si ambulancë veterinarë, si klinikë veterinarë respektivisht si stacion ose spital dhe shërbim veterinar të mbarështimoreve të për momentin i plotësojnë kushtet për kryerjen e veprimtarisë veterinarë-shëndetësore, dhe se janë miratuar pas thirrjes publike të shpallur në korrik të vitit 2016. Në thirrjen mund të paraqiten personat juridikë, të regjistruar për kryerjen e veprimtarisë veterinarë-shëndetësore duke përmbyllë me ditën e publikimit të thirrjes.

2.1.2 Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është pesë ditë pune duke llogaritur nga dita pasme prej ditës së shpalljes.

3. Të dhënat të hollësishme dhe kontakti për informacione

Të dhënat e detajuara dhe formularët e aplikimit mund të shkarkohen nga lidhja e mëposhtme: www.fva.gov.mk

Tel: 02-2457893 ose 02-2457873

Faksi: 02-2457893, lokal 147

e-mail: info@fva.gov.mk

Koha <http://www.koha.mk> Search

E përditshme informative

Koha

www.koha.mk
koha@koha.com.mk | marketing@koha.com.mk
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;
Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovazja lok.14 - përdhësë, Shkup



Ekspertët japin alarmin për Facebook-un: Hiqni dorë menjëherë!

Shkencëtarët besojnë se kanë arritur të gjejnë arsyen përse njerëzit shohin gjatë gjithë kohës rrjetin social Facebook. Gjithçka, sipas tyre, ndodh sepse i bën të ndihen mirë. Edhe të parit diçka që ka lidhje me Facebook për një kohë fare të shkurtër, si një logo, sipas ekspertëve i sjell njerëzve shumë kënaqësi. Dëshira për ta përsëritur këtë kënaqësi bën që njerëzit të futen gjatë gjithë kohës dhe i bën ata të paduruar kur nuk kanë mundësi.

Kur vendosin që të largohen nga Facebook, njerëzve u mungon kjo kënaqësi. Fillojnë të ndihen në faj, shkojnë sërish në Facebook për t'u ndjerë sërish mirë, e më pas ndihen sërish keq. Shkencëtarët thonë se kjo sjellje është një "cikël i dështimit të vetë rregullimit" që i bën njerëzit të shkojnë online, të dalin e të futen sërish. E gjithë ndjenja e fajit për pamundësinë për t'u shkëputur nga rrjeti social, po dëmton vetë psikikën, thotë Allison Eden nga Universiteti Shtetëror i Michigan, që realizoi këtë studim.

"Njerëzit bëjmë mirë që ta detyrojnë veten për ta fshirë Facebook totalisht nga jeta e tyre", thotë ajo më tej. Sipas asaj që shkruan "The Independent", grupi i ekspertëve realizuan dy studime, duke vëzhguar ata që përdornin Facebook dhe ata që e përdornin më pak. Në studimin e parë, njerëzve iu kërkua që të shihnin diçka që kishte lidhje me Facebook, si një logo, ose diçka tjetër dhe më pas një simbol kinez. Atyre më pas iu kërkua që të thoshin nëse simboli ishte i këndshëm ose jo. Ata që e përdornin Facebook gjatë gjithë kohës dhe kishin parë një imazh që kishte lidhje me rrjetin social, kishin më shumë gjasë që të thonin se simboli kinez ishte i këndshëm. "Njerëzit po mësojnë këtë ndjenjë e shpërblimit kur futen në Facebook", tha Eden. "Ajo që ne tregojmë me këtë studim është se edhe me diçka kaq të thjeshtë sa logoja e Facebook, të parit murin e një miku në Facebook apo diçka që lidhet me vetë Facebook, është e mjaftueshme për të përcjellë një ndjenjë pozitive". Në studimin e dytë, njerëzve iu kërkua që të matnin dëshirën e tyre për t'u futur në Facebook. Ata panë se njerëzit i dorëzoheshin tundimit për ta përdorur rrjetin social dhe binin në rrethin e dështimit, që mund të dëmtojë psikikën e tyre.

ZAKONET E KËQIJA TË PRINDËRVE TRASHËGOHEN



Sipas studiuësve, stili i jetesës prindërore përcakton nga 31 deri në 78% stilin e jetesës dhe gjendjes shëndetësore të pasardhësve kur ata rriten

Fëmijët tanë na shohin gjithmonë, madje edhe kur tymosim apo kur pimë, dhe ata do të na emulojnë për fat të keq, duke na pasqyruar gabimet tona. Dhe çdo sjellje e keqe e jona do të pasqyrohet tek ata në të ardhmen. Thuhet (dhe shkruhet shpesh), por repetita iu-vant (sjellje e përsëritur): ja vlen më shumë se një shembull i mirë i dënimeve. Ndoshta shembulli jep rezultatet e tij në kohë, por për një kohë të gjatë është i pa-pur. Ose pothuajse. Çështja është se shembulli është vendimtar edhe kur është i keq dhe prindërit duhet të dinë që duke u dhënë fëmijëve vese kushtëzojnë gjithmonë shëndetin e tyre. Këtë gjë e konfirmon dhe e thekson edhe një kërkim tjetër, këtë herë me origjinë britanike.

SJELLJET. Varësia nga duhani dhe alkooli, jeta e ulur dhe ushqimi i keq: të gjitha bien në sfondin e asaj që ekspertët e quajnë "mënyra e jetesës" dhe kjo duket të jetë gjithnjë e më e rëndësishme në përcaktimin e shëndetit dhe në pritshmëritë e jetës përtej gjeneve që ndonjëherë duken se

kanë vendosur fatin tonë, por ndërkohë nuk është kështu. Kjo rëndësi në rritje e dhënë nga studiuesit në mënyrën e jetesës është një shenjë e rëndësishme e vetëvendosjes, por nga ana tjetër duhet të thuhet se në fakt, madje as në vendosjen e stilit të jetesës nuk jemi kaq të lirë, sepse sjelljet e mësuara nga prindërit kanë një ndikim të madh në zgjedhjet tona të ardhshme.

STUDIMI. Studiuesit e Universitetit Leeds flasin qartë për hulumtimet e tyre të fundit dhe përfshijnë një mostër prej 21,000 personash të shpërndarë nëpër 13 vende. Rastësia e shembullit të keq luhatet jo pak, duke filluar nga 31% deri në 78%, me një incidencë mesatare të gjysmës së sjelljeve (dhe do të ishte interesante të shpjegoheshin arsyet për këtë lëkundje). Për shembull, në Republikën Çeke, Gjermani, Spanjë, Francë dhe Austri, kapaciteti i prindërve për të sulmuar pasojat e zakoneve të këqija ndikon afërsisht 70% (pak a shumë). Në Belgjikë, Holandë dhe Zvicër ndikon rreth 41%. Dhe pastaj është Suedia, ku për motive mi-


sterioze mami dhe babi gati kurrë nuk i sulmojnë sjelljet e fëmijëve të tyre. Kjo mund të ndodhë sepse të rinjtë i nënshtrohen kufizimeve aq të forta nga burimet e tjera për pirjen e duhanit për të anuluar efektin e shembullit prindëror (që megjithatë është normalisht pozitiv). Në fakt, modeli suedez i parandalimit të pirjes së duhanit njihet si një model i suksesshëm dhe Suedia është vendi evropian me prevalencën më të ulët të duhanpirësve të përditshëm në popullatën e rritur, si dhe i pari për të shkurtuar objektivin rreth 20%, të rekomanduar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

MOSHA ENDIKIMIT. Shkurtimeisht, prindërit u japin fëmijëve të tyre jo vetëm materiale gjenetike, por edhe stilin e tyre të jetesës. Përtej faktit se ekziston një shkencë e quajtur epigenetikë që konsiston në një model që shpjegon se si faktorët mjedisorë kanë një ndikim të thellë në sjelljen e gjeneve. Në thelb një fëmijë i lindur në një familje që ka një jetë jo shumë të mirë (që shkon përtej pirjes së duhanit,

abuzimit me alkoolin dhe dietës së keqe) rrezikon të jetë para-programuar që të ketë probleme shëndetësore. Por gjithmonë në varësi se ku është lindur dhe, me sa duket, edhe nga mosha kur sjelljet shihen dhe pranohen. Për shembull, nëse një fëmijë i moshës 12 vjeç, moshë midis pubertetit dhe adoleshencës, sheh babain e tij duke pirë duhan, mundësitë për t'u bërë duhanpirës janë pothuajse dyfish. Në përgjithësi një nënë duhanpirëse ndikon shumë në zgjedhjet e ardhshme të vajzës së saj dhe shumë më pak tek zgjedhjet e djalit (kjo është për shkak se fëmija tenton të identifikohet me prindin e të njëjtit seks). Gjithashtu duket se rreziqet për t'u bërë duhanpirës rriten nëse babai bën një punë manuale ose nëse ka jetuar në varfëri gjatë fëmijërisë. Shkurtimeisht, ka fushata të mira ndërgjegjësimi dhe aktivitete edukative, reklama dhe fotografi të tmerrshme në pako cigaresh apo edhe promovimi i palestrës. Por megjithatë familja, në kuptimin e bukur dhe të shëmtuar, mbetet më e rëndësishme.

KUJDES! FJETJA ME SHPINË GJATË SHTATZËNISË ËSHTË E RREZIKSHME

Gratë shtatzëna që flenë në shpinë gjatë tremujorit të tretë janë të pritura të vuajnë më shumë gjatë lindjes sipas një studimi të ri. Do të kishte një rënie prej 3.7 për qind të lindjeve nëse të gjitha gratë shtatzëna në Britani të Madhe flinin në anën e tyre gjatë tremujorit të fundit, vlerëson ky studim. Ky hulumtim ka zbuluar se normat e zemrës së foshnjave janë më pak aktive kur nënat e tyre flenë me shpinë, gjë që mund të jetë për shkak të peshës së fetuseve që bëjnë presion mbi enët e gjakut dhe prandaj kufizojnë furnizimin me oksigjen



të foshnjave. Autori kryesor Alexander Heazell nga Qendra e Hulumtimit të Qëndrueshmërisë së Tommy në Spitalin e Shën Marisë në Mançester tha: "Rreth 11 foshnje lindin çdo ditë në

Mbretërinë e Bashkuar. Prindërit duan të dinë pse fëmija i tyre kanë vdekur, nëse kjo mund të ndodhë përsëri nëse ata përpiqen për një fëmijë tjetër dhe çfarë mund të bëjnë për të sh-

mangur problemet e mëtejshme të lindjes. Hulumtuesit analizuan 1.024 gra nga 41 njësi të lindjes në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar. Nga të cilat, 291 pësuan abort në 28 javë ose më shumë gjatë shtatzënisë së tyre. 733 e tjera që kishin mbetur ish-in ende shtatzënë në kohën e studimit. Të gjithë pjesëmarrësit në studim plotësuan një pyetësor që pyeste për praktikën e tyre të gjumit para se të mбетeshin shtatzëna, si edhe katër javë dhe natën para se të plotësonin pyetësorin ose të vuanin një abort. Rezultatet tregojnë se gratë shtatzëna që flenë në shpinë gjatë tremujorit të tretë janë 2.3 herë më shumë të ngjarë të vuajnë gjatë lindjes së foshnjës në krahasim me ata që anojnë në anën e tyre.



Një ditë në nëntor 1915: dy diplomatë qëndrojnë në një tryezë të gjatë e të drunjtë, në një dhomë të fshehtë në Bagdad. Një hartë, një vizore dhe një laps përpara tyre. Të tre këta objekte do të shkaktojnë luftëra të pafund, do të shkaktojnë miliona të vdekur, do të destabilizojnë një rajon të tërë dhe madje do të hedhin farën e terrorizmit modern. Në këtë ditë, francezi Francois Georges-Picot dhe anglezi Mark Sykes ndajnë Perandorinë Otomane - dhe thyejnë një prem-tim. Si aleatë kundër trupave gjermane dhe turke, ata u kishin prem-

NËNTOR 1915:

DITA KUR NJË KUFË I KRIJUAR ME NXITIM, SHKAKTON KONFLIKTIN MË TË MADH NË HISTORINË E NJERËZIMIT



tuar arabëve shtetin e tyre të pavarur pas Luftës së Parë Botërore. Marrëveshja Sykes-Picot hyri në fuqi në nëntor 1916. Kufijtë që ajo krijon hedhin themelet për lindjen e Irakut. Por mënyra si u bënë këta kufij, nuk ka asgjë të bëjë me pavarësinë e premtuar të fiseve arabe. Rajone të lidhur etnikisht ndahen.

Iraku lind vërtetë në vitin 1920, por ai nuk është shtet sovran. Britanikët rrezojnë qeveritë që nuk i pëlqejnë atje, deri kur Saddam Huseini vjen në pushtet në vitin 1979. Vite të tërë tiranie të tmerrshme, tre luftëra të Gjirit dhe rrëzimi i Sadamit në vitin 2003 do i vinin vulën. Lapsat e Sykes dhe Picot krijojnë justifikimi-

min për pothuaj 100 vite luftë, persekutime dhe masakra në Lindjen e Mesme - si dhe për krijimin e dhjetëra organizatave terroriste. "Këta kufij kombëtarë artificialë kanë krijuar shumë konflikte me kalimin e dekadave", thotë Henner Fuertig, ekspert i studimeve mbi Lindjen e Mesme.

Nga 14 dhjetori interneti nuk do të jetë më i njëjtë?

Qeveria amerikane është duke u përgatitur për të dërguar neutralitetin e internetit në histori. Neutraliteti i internetit nënkupton që i gjithë trafiku aty të trajtohet në mënyrë të barabartë. Megjithatë, rregullat e reja do të lejojnë ofruesit e internetit të bllokohen ose të ngadalësojnë qasjen në faqe të caktuara. Aktualisht, operatorët nuk mund të ofrojnë trajtim të veçantë në asnjë faqe. Me ligjin e ri, do të jetë në gjendje të lejojë disa faqe të hapen më shpejt, ndërsa qasja ndaj dikujt tjetër do të ngarkohet më shumë. Kundër heqjes së neutralitetit në internet janë duke luftuar kompanitë e mëdha të internetit të tilla si Google, Netflix, Facebook dhe Reddit. Projektligji do të votohet më 14 dhjetor dhe nëse miratohet, interneti nuk do të jetë më i njëjtë, pasi që më saktë do të duket më shumë si televizion kabllor.

PETRA, PËRSE U NDËRTUA NJË TEATËR PËR TË VDEKURIT?



Agorge shënon hyrjen në një prej mistereve më të mëdha të botës së lashtë. Rrugëkalimi i ngushtë vazhdon për më shumë se një kilometër e gjysmë, mes mureve shkëmborë 100 metra të lartë, deri kur hapet në një fasadë gjigande të skalitur në shkëmbin e kuq: Petra, një mega-metropol i harruar për shekuj të tërë dhe kryeqytet i qytetërimit enigmatik Nabatean. Rreth 2000 vjet më parë, një tribu nomadësh arabë krijoi një njëjtë tregtare tejet të sofistikuar që mbulonte një hapësirë prej 18 kilometrash katrorë, në skajet e shk-

retitërisë jordanëze. Deri sot, vetëm një pjesë e qytetit është gërmuar, duke lënë të pazbuluar shumë mistere. Ndoshta më i madhi prej këtyre mistereve është kompleksi i madh i teatrove, i cili u skalit në brendësi të shkëmbit në një kohë kur Jezusi i Nazaretit predikonte ungjillin vetëm pak kilometra më në veri. Teatri ka 45 radhë që mund të rehatojnë deri 10 mijë njerëz, dhe ndodhet shumë pranë varreve në shkëmb të Nabateanëve. Një koincidencë e pastër? Ndoshta jo. Shihni fotografinë: audiencia mund të jetë më pranë mbretërisë

së të vdekurve, nga sa mendojnë. Ato vrima të zeza në murin e pasëm mbi reshtin e fundit janë varre - një vrimë përgjimi nga bota e nëndheshme; "sedilje" për të vdekurit. Shkencëtarët janë të ndarë. A zhvillojnë shfaqje në brendësi të amfiteatrit? Apo përdorej për funerale me flijime njerëzore? Arkeologu izraelit, Avraham Negev beson se teatri shërbente për funerale në kultin e funeraleve të Nabateanëve, sepse kur më në fund u hapën varret, ata ishin bosh. Duket se fantazmat janë larguar prej kohësh nga teatri.



MALLKIMI I CHE GUEVARËS

Persona të ndryshëm që u përfshinë në vrasjen e Ernesto Che Guevarës në Bolivi, gjetën vdekje të dhunshme, aq sa krijuan legjendën e një "mallkimi të Che". I pari që humbi jetën, prej rënies së pashpjegueshme të helikopterit të tij, në vitin 1969, ishte presidenti i Bolivisë, Rene Barrientos. Po atë vit Honorato Rojas, fshatari që kishte tradhëtuar Che Guevarën duke zbuluar vendndodhjen e tij, u ekzekutua nga ushtria e guerillasve bolivianë.

Në vitin 1971, koloneli Roberto Quintanilla, shefi i shërbimeve të fshehtë bolivianë, që mori gjurmët e gishtërinjve të Che Guevarës pasi i ishin prerë duart, u vra në Gjermani nga Monika Ertl, "engjëlli hakmarrës i Che". Më pas, Ertl do të vritej në një pritë të organizuar prej kriminelit nazist, Klaus Barbie.

Në vitin 1973, Andres Selich, ushtaraku bolivian që mori në pyetje Che Guevarën pas kapjes së tij, u vra me shkopinj nga militarët e Hugo Banzer, presidenti i ri bolivian, i ardhur në pushtet me një grusht shteti, dy vite më herët.

Koloneli Joaquín Zenteno Anaya, i cili kishte zbatuar urdhërin e vrasjes së Che, pasi e kishte marrë nga shefi i Sh-tabit, Juan Jose Torres, u vra në vitin 1976 në Paris nga "Brigata Ndërkombëtare Che Guevara". Nga ana e tij, Torres u vra në Buenos Aires në vitin 1976, nga një organizatë e të djathtës ekstreme argentinase.

Mario Teran, që ekzekutoi Che Guevarën, ka jetuar gjithmonë i fshehur, nën terrorin e një hakmarrjeje të mundshme.

Felix Rodriguez, agjenti i CIA-s që identifikoi Che Guevarën për qeverinë amerikane u godit nga një formë e rëndë astme: e njëjta që kishte përndjekur Che Guevarën përgjatë gjithë jetës së tij.



DASHI 21. mars - 20. prill

Jeta juaj në çift nuk do jetë aspak monotone gjatë kësaj dite. Përkundrazi do provoni emocione të reja të cilat do ju bëjnë të ndiheni si mbi re. Beqarët do jenë të pasigurtë për atë që duan të bëjnë dhe nuk do hedhin asnjë hap. Në planin financiar mos e teproni me shpenzimet sepse situata mund t'ju dalë jashtë çdo kontrolli. Bëni kujdes!



DEMI 21. prill - 21. maj

Ditë shumë e rëndësishme kjo e sotmja për ata që janë në një lidhje. Jo vetëm që do afroheni më tepër me partnerin/en, por do merrni edhe vendime të rëndësishme. Beqarët nuk do vuajnë më nga vetmia sepse do e gjejnë një person interesant. Në planin financiar situata do jetë paksa delikate, por me maturi gjerat mund të përmirësohen.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Marrëdhënia në çift nuk do jetë e keqe gjatë kësaj dite, megjithatë nuk është ende momenti për të marrë vendime të rëndësishme. Bëhuni më të duruar. Beqarët do jenë të pavendosur për atë që duan të bëjnë me jetën e tyre. Në planin financiar duhet të hiqni dorë nga shpenzimet marramendëse.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Dialogu, bashkëpunimi dhe toleranca do mbizotërojnë sot në jetën tuaj në çift. Do i sqaroni edhe mosmarrëveshjet dhe do ndiheni më të çliruar për të dashuruar ashtu si e ndjeni. Beqarët do e kenë të vështirë ta lënë veten të lirë për të gjetur personin e përshtatshëm. Financat do jenë aq të mira saqë ju mund të kryeni edhe ndonjë transaksion.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Do i lini pas debatet dhe mosmarrëveshjet që keni pasur në çift gjatë kësaj dite dhe do filloni një etapë të re dhe më të bukur se më parë. Beqarët nga ana tjetër do fillojnë të njihen më mirë me një koleg të tyre. Nëse ai ju pëlqen vërtet mos kini frikë të hidhni hapa. Me financat gjithçka do shkojë mirë.



VIRJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Ditë plot ngjyra kjo e sotmja për ata që janë në një lidhje. Do kaloni momente të paharuar pranë personit që dashuron dhe do dëshironi që gjërat të vazhdojnë kështu deri në përjetësi. Beqarët do kenë disa takime, por nuk do jenë të bindur nëse ata persona janë të duhurit. Në planin financiar do jeni me shume fat dhe situata do përmirësohet.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Momentet e lumtura do jenë të shumta gjatë kësaj dite dhe do ndiheni mjaft mirë pranë atij/asaj që dashuron. Shfrytëzoni çdo sekondë sikur të ishte e fundit. Beqarët do përfitojnë pa fund nga liria që kanë dhe do kalojnë më tepër kohë me miqtë. Në planin financiar do jeni me shumë fat.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Nëse jeta juaj në çift është e trazuar sot situata mund edhe të përqeshohet më tepër. Tregohuni të kujdesshëm me ato që do thoni dhe vendosni arsyen mbi gjithçka tjetër. Beqarët do bëjnë mirë të mos i besojnë shumë pamjes së jashtme. Financat fatmirësisht do kenë goxha ndryshime pozitive.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Jeta në çift do shkojë për mrekulli gjatë kësaj dite. Do fillojnë projekte së bashku me atë që keni në krah dhe në këtë mënyrë do afroheni më tepër me njeri-tjetrin. Beqarët edhe pse do mundohen shumë nuk do mund ta gjejnë princin e tyre të kaltër. Financat do jenë të turbullta, kujdes me shpenzimet.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Jeta juaj në çift do jetë mjaft e kërcënuar sot dhe kjo për shkak të sjelljes aspak të mirë që ju keni treguar. Mundohuni të gjeni momentin e duhur për të folur qetësisht me partnerin/en. Beqarëve do ju ndodhë diçka e çuditshme, por që mund t'ua ndryshojë jetën. Financat do jenë të paqëndrueshme.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Ata që janë në një lidhje do flasin më hapur me partnerin/en e tyre dhe pak nga pak do e stabilizojnë lidhjen. Do dinë edhe të kërkojnë falje. Beqarët do e shfrytëzojnë lirinë që kanë për të dalë sa më shumë me miqtë dhe për të bërë çmenduri me ta. Në planin financiar mendoni edhe për të ardhmen.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Komunikimi në çift do shtohet gjatë kësaj dite dhe marrëdhënia mes jush dhe partnerit/ës do fillojë të përmirësohet ndjeshëm. Në fund do i shprehni më lirish atë që ndjeni. Beqarët do lodhen së kërkuari, por në orët e mbrëmjes do e gjejnë personin e duhur. Situata financiare do jetë paksa delikate.



KOHA	NË STIL I KARATESE AKTORI E MIESHTRI I ARTEVE MARCIALE (FOTO)	SH	SELENI	IMPULSI	AR (FRËNGJ.) NË NJË NGJASHTETET E NIGERISE	QYTETI I LASHTË NË AZINË E VOGËL KAFSHË DINAKE	DEGË E MEKANIKËS
FILM ME AKTORIN NË FOTO							TEMPERATURA HYJNESHË NË MITOLOGJINË NORDIKE
RADIO TELEVIZIONI SPANJOLL				GAZETARIA MIGENA ISH VRAPUESI MAROKAN, AJITA			
UNIONI ORTODOKS RRIP LLASTIKU KRAHAQAFË PËR TË MBAJTUR PANTALLONAT			SHPEND GRABITQAR, PETRITET REVOLUCIONARJA PALIKUCI				
A					BOTUESI I LIBRIT 'BESONI APO JO', ROBERT NIKEL		
BANORË TË LABINOTT, LABË FUTBOLLISTI ZIDAN							KALIUMI INTENSITETI
Z						KËNGËTARI DHE KITARISTI ANGLEZ, KRIS	

ZGJIDHJET: KROS, THEPI, IVON, MINA, ISEN, UITNI, DAT, SH, OR, IS, BOSI I MADH, T, RTE, MIGENA, UO, SOKOLAT, ASKIA, RIPLI, LABINOTË, K, ZINEDIN, RIA.

Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

5	6			9					2			1	3			4	
	2	1		6										6		2	
				8		1	2			7	6	2					5
6					4				4		7	3					
			5		2		7			5							7
							9							5	9		4
		7	4	9			3							3	8	9	
			6			1		8	7	2		9					
4						5					4		2	1			7

Shumë i lehtë: 564219387, 821367954, 793548612, 678931425, 915824763, 342756891, 187495236, 259673148, 436182579. Mesatar: 285137649, 149586723, 376294185, 417369258, 958412376, 632875914, 561743892, 723958461, 894621537.

ËSHTË PICKUAR MBI 1 MIJË HERË: DO STUDIOJ INSEKTET DERI SA TË KEM JETË

Në Tuscon, Arizona, ky shkencëtar ka shpenzuar gjysmën e jetës së tij duke studiuar insekte të ndryshme. Por speciet që ai studion, nuk janë dosido, pasi të pickojnë. Justin Schmidt, shprehet se është pickuar mbi 1000 herë në gjatë punës së tij.

Për shkak të eksperiencave të tij të hidhura, shkencëtarit ka krijuar edhe një "shkallë të dhimbjeve nga pickimet". E quajtur "The Schmidt pain scale", ajo ka 4 nivele, nga më e pakta deri tek pickimi që dhemb më shumë. Niveli I fundit për të është pickimi nga insekti i quajtur "Ta-



rantula hawk". Sipas shkencëtarit, në këtë fazë, mund të të bjerë të fikët nga dhimbja. Justin Schmidt shprehet pa-



varësisht vështirëve të punës, ai do të vazhdojë ti studiojë këto insekte deri sa të ketë jetë.

GJERMANIA NDALON SHITJEN E ORËVE INTELIGJENTE PËR FËMIJËT

Autoritetet Gjermane ndaluan shitjen e orëve inteligjente për fëmijë duke thënë se janë përdorur për përgjime, transmeton PCWorld Albanian. Një lëvizje e ngjashme u aplikua edhe për kukullën My Friend Cayla për të njëjtat arsye. Gjithashtu ata paralajmëruan prindërit ti shkatërrojnë këto pajisje. Në

një njoftim zyrtar, autoritetet thanë se kishin marrë masa edhe ndaj firmave që shesin produkte të tilla.

Pajisje të tilla zakonisht u dedikohen moshave të vogla nga 5 deri në 12 vjeç. Shumica e tyre kanë një kartë SIM dhe funksionalitete të kufizuara telefonie të cilat shfrytëzohen me anë të një aplika-

cioni. Ca prej tyre ruanin të dhëna pa enkriptim. Kjo do të thotë se hakerat mund ti hakonin duke përdorur edhe teknikat më bazike. Nuk dihet nëse një vendim i tillë i marrë nga autoritetet Gjermane erdhi si rezultat i shqetësimeve të privatësisë apo probleme reale sigurie.

MË NDIHMONI, GJOKSI IM DO PËLÇASË!

Sheridan Larkman është një vajzë 23-vjeçare në Australi, e cila po mbledh para në internet për të bërë ndërhyrje kirurgjikale në gjoks. Ndryshe nga shumica e femrave të tjera, ajo kërkon që ta zvogëlojë gjoksin për shkak të madhësisë. 23-vjeçarja, e cila është edhe nënë e dy fëmijëve, përballet me situata të vështira në jetën e saj. Ajo ka hapur një faqe në internet, GoFundMe për të mbledhur fonde në mënyrë që të bëjë ndërhyrje kirurgjikale. Shuma e parave që i duhen është 10 mijë dollarë. Nuk mjafton halli që ka, por duhet të përballet edhe me komentet vulgare të komentuesve në faqen e internetit. Që në moshë të vogël, gjoksi



i 23-vjeçares ishte zhvilluar së tepërmi, por mjekët e kishin thënë se do të ndalonte së rrituri në një moshë më të madhe. Por, kjo gjë nuk ndodhi dhe Sheridan tani kërkon ndihmë për të rregulluar këtë aspekt të jetës së saj.



AUTOBUSË QË LËVIZIN ME KAFË!

Gjyset tona thoshin se mbetjet e kafesë mund të përdoren në shumë mënyra, që nga maskat e bukurisë e deri te plehu për bimët. Por, zori se gjyset do ta kishin menduar se me to do të prodhohej edhe karburant. Në Londër, në fakt janë vënë në lëvizje autobusët e parë që djegin mbeturinat e kafesë, falë shpikjes së 27-vjeçarit Arthur Kay. Ky i fundit, themelues dhe presidenti i kompanisë "Bio-Bean" ideoi një proces, përmes të cilit nxjerr nga mbeturinat e pijes më popullore në botë vaj kafeje, transmeton tch. Më pas, vaji i kafesë përzihet me dieselin e zakonshëm, duke krijuar një biometan



apo "B20", siç quhet, dhe që vë në lëvizje autobusët. Nuk bëhet fjalë për një karburant 100% të gjelbër, por përzjerja me kafën ul tej mase ndotjen që krijon nafta

e zakonshme. Avantazhet e shpikjes janë të mëdha, e mes tyre përfshihen riciklimi i mbeturinave të kafesë, reduktimi i dioksidit të karbonit dhe kursimi i karburantit. Deri tani, kompania "Bio-Bean" ka prodhuar 6.000 litra vaj kafeje nga mbeturinat e rreth 2.5 milionë filxhanëve. Por, nëse llogarisim se në Britani konsumohen 2.5 miliardë filxhanë kafeje në vit, sasia e riciklimit të mbeturinave dhe karburantit më të pastër do të ishte shumë e madhe. Imagjinoni nëse kjo skemë shkon në Itali, shtëpia europiane e kafesë, ku konsumohen mesatarisht 39 miliardë filxhanë kafeje në vit.



KALENDARI HISTORIK 27 NËNTOR

1807 - Familja mbretërore e Portugalisë ikë nga Lisbona për të shpëtuar nga trupat e Napoleonit.

1815 - Qyteti i Krakovit (Poloni) shpallet republikë e lirë nga ana e Kongresit të Vjenës.



1895 - Alfred Nobel themelon Çmimin Nobel.

1926 - Italia dhe Shqipëria nënshkruajnë marrëveshje të pa-

ques.

1965 - 15-25,000 persona demonstrojnë në Uashington DC kundër luftës në Vietnam.

1985 - Republika e Irlandës merr rol konsultativ në Irlandën Veriore.

1994 - Një zjarr i madh shkaktohet në një disko në Fuxhin, Kinën Veriore ku vdesin 233 persona.

Të lësh fëmijët nën moshën dy vjeç para televizorit, nuk është një ide e mirë. Sipas një studimi amerikan të "Seattle Children's Hospital", fëmijëve nën moshën 2 vjeç, shikimi i televizorit nuk u bën mirë. Ky studim është publikuar në revistën "Acta Paediatrica", ku theksohet se ndjekja e televizorit me kohë të zgjatur, nuk lejon zhvillimin normal të një të mituri. Gjithashtu, sipas studimit, fëmijët nuk duhet të kalojnë shumë orë duke parë filma vizatimorë, pasi kjo mund t'i lidhë përherë e më shumë me ekranin e televizorit. Të dhënat flasin se në SHBA, vetëm 6% e prindërve e dinë me saktësi se çfarë rreziqesh kanë fëmijët që shikojnë me orë të zgjatura televizorin.



A E DINI SE...



BARSOLETA

Dy policë shërbimi u futën në një dyqan orësh dhe blenë njëri një orë që i rezistonte ujit dhe tjetri orë me kuarc. Pas disa ditësh po bënin shërbim përsëri bashkë dhe njëri pyet tjetrin.

- Si të shkon ora?

- Mirë - i përgjigjet tjetri - po nuk më ka rënë rasti ta fus në ujë se nuk kam shkuar në plazh!

- Po ty, si të shkon?

- Lëre lëre - i thotë tjetri - unë po ha dynjanë, ja tani ora është 12:05 dhe sa mundohem të bëj pjesëtimin, ajo bëhet 12:06, unë mundohem përsëri dhe shikoj se ora shënon 12:07... dhe kështu nuk kam arritur të bëj asnjë pjesëtim.



THËNIA E DITËS



Guximi nuk është mungesa e frikës, është frymëzimi që ti u jep të tjerëve për të ecur përpara!
(Nelson Mandela)